

Silvana Nini

Zeni Ballazhi

Hazir Haziri

ART FIGURATIV 6

Për klasën e 6-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2024



Librin për mësuesin mund ta shkarkoni në linkun: <https://www.botimepegi.al/>

Art figurativ 6

ISBN: 978-9951-843-30-0



9 789951 843300




Silvana Nini

Hazir Haziri


Zeni Ballazhi

Art figurativ 6



BOTIME

pegi





Lejohet për botim teksti shkollor për klasën e xxxx, me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, nr.xxxxxxx

BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t: xxxxxxxxxx
Redaktore letrare: Aida BARO
Korrektore letrare: Oriada DAKO
Paraqitja grafike: Suela NINI, Florinda ZONJA
Kopertina: Florinda ZONJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-843-30-0

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, maj 2024
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: cel: +355 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355 069 20 267 73; 069 40 106 88;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Hyrje

Lënda e “Artit figurativ 6” i ndihmon nxënësit të nxjerrin në dukje kreativitetin e tyre dhe të zhvillojnë imagjinatën. Nëpërmjet artit, ata kanë mundësi të zbulojnë fuqinë e fantazisë së tyre, duke shprehur ide dhe duke rritur aftësitë krijuese. Arti figurativ u mëson nxënësve të eksplorojnë të bukurën në natyrë dhe në mjedisin që i rrethon, si dhe u krijon hapësirën e duhur për të shprehur lirshëm ndjesitë e tyre.

Arti figurativ i ndihmon nxënësit të përmirësojnë performancën edhe në lëndët e tjera, duke zhvilluar dhe përmirësuar aftësitë e të nxënit nëpërmjet praktikimit të teknikave artistike.

Nëpërmjet artit figurativ, ata u japin formë ndjenjave, ëndrrave dhe fantazisë. Krijimi në artin pamor i bën të ndihen mirë dhe i motivon për të ecur përpara në kërkimet e tyre artistike.

Në këtë libër, nxënësit do t’u referohen shpeshherë veprave të artistëve të njohur, çka i ndihmon të zgjerojnë njohuritë rreth artit figurativ. Edukimi nëpërmjet artit figurativ i ndihmon ata të shohin dhe analizojnë vepra të njohura të artit, punimet e tyre dhe të shokëve e shoqeve të klasës. Në këtë mënyrë, nxënësit zhvillojnë aftësitë për të vlerësuar krijimet artistike.

PËRMBAJTJE

GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK

1. Perceptimi pamor	6
2. Shenja dhe pika	10
3. Vija	14
4. Forma dydimensionale	18
5. Ngjyra	22
6. Tekstura	26
7. Vëllimi	30
8. Hapësira	34
9. Baraspesha	39
9. Ritmi dhe harmonia	43
11. Kontrasti	46
12. Proporcionet	49

KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

1. Vizatimi	54
2. Piktura	56
3. Mozaiku	58
4. Shtypi	60
5. Fotografia	62
6. Dizajni grafik	64
7. Skulptura	66
8. Konstruksioni në arkitekturë	68



RELACIONI ART-SHOQËRI

1. Arti në parahistori	72
2. Arti në Mesopotami	75
3. Arti egjiptian	78
4. Arti grek	81
5. Arti romak	84
6. Qytetet antike në Kosovë dhe Shqipëri	87
7. Arti islam	91
8. Arkeologjia, restaurimi dhe muzeu	94





GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK

Vëzhgimi dhe shprehja nëpërmjet gjuhës pamore

Kur flasim dhe shkruajmë, ne e përdorim gjuhën në përputhje me rregullat gramatikore. Edhe kur shprehemi dhe komunikojmë përmes imazheve, kemi nevojë për rregulla. Gjuha pamore ka gramatikën e saj, e cila përbëhet nga: pika, vija, forma, ngjyra etj., dhe rregullat e saj.

Kjo tematikë është ndërtuar në mënyrë të tillë që secili nga ne, pavarësisht përvojave, të ketë mundësi të krijojë dhe të komunikojë nëpërmjet gjuhës pamore.

“Gjuha dhe komunikimi artistik” propozon tri kompetenca kryesore, të cilat janë: aftësia për të vëzhguar natyrën e realitetin që na rrethon dhe për të zbuluar në to praninë e shenjave pamore, të cilat përdoren në krijim; përdorimi i teknikave të ndryshme si: vizatimi, piktura, kolazhi, skulptura etj., për të realizuar idetë krijuese nëpërmjet rregullave të gramatikës pamore; identifikimi dhe vlerësimi i elementeve artistike të pasqyruara në këto krijime.

Mësimet 1-12

Njohuritë:

- **Elementet e artit:** Perceptimi pamor. Shenja dhe pika. Vija. Forma dydimensionale. Ngjyra. Tekstura. Vëllimi. Hapësira.
- **Parimet e kompozimit:** Baraspesha. Ritmi dhe harmonia. Kontrasti. Proporcionet.

Rezultatet e të nxënës:

Nxënësi/jja:

- *Shikon me vëmendje mjedisin që e rrethon dhe imazhe të ndryshme artistike, për të perceptuar elementet dhe parimet e gjuhës artistike;*
- *reflekton mbi imazhet si pjesë përbërëse të mjedisit;*
- *zbulon karakteristikat shprehëse të elementeve dhe parimeve të kompozimit;*
- *përdor në mënyrë të qëllimshme elementet dhe parimet e gjuhës artistike në krijim.*

PERCEPTIMI PAMOR

Shiko dhe diskuto

Në figurën e mëposhtme paraqitet një vajzë, e cila mbledh të dhënat e nevojshme për të realizuar punimin. Ajo shikon, dallon ngjyrat, prek materialin. Cilat shqisa na ndihmojnë të mbledhim informacionin e duhur për të realizuar një punim artistik?



①

Pesë shqisat tona mbledhin fakte mbi çdo gjë që na rrethon dhe këtë informacion ia përcjellin trurit. Prej këtij informacioni, truri ynë ndërton një imazh të saktë të mjedisit ku jetojmë. Objektet janë reale, nëse mund t'i shohim, t'i dëgjojmë, t'i prekim, t'i nuhasim dhe t'i shijojmë. Informacionin që na vjen nga bota e jashtme e përzgjedhim në bazë të nevojave që kemi. Truri ynë analizon në mënyrë të vazhdueshme informacionin që vjen nga bota e jashtme. Të perceptosh do të thotë të kuptosh praninë e një objekti dhe të njohësh disa karakteristika të tij, nëpërmjet shqisave.





Të parit

Të parit është një prej shqisave tona më të rëndësishme. Pjesa më e madhe e perceptimeve janë pamore dhe ndikohen nga ato që shohim. Mjafton të shohim një lule trëndafili për të kujtuar aromën, të shohim nga dritarja gjethet e pemës që lëvizin për të kuptuar se po fryn erë etj.

Si funksionon syri ynë?

Syri ynë mund të shohë vetëm objekte që janë të ndriçuara (fig. 2). Pjesa më e dukshme e syrit të njeriut është irisi, i cili në qendër ka bebëzën. Në errësirë, bebëza zmadhohet për të marrë më shumë dritë, ndërsa në prani të saj, zvogëlohet me qëllim që drita e fortë të mos e godasë retinën.





Drita hyn në sy nëpërmjet bebëzës. Ajo bie në kontakt me lentin. Kjo lente quhet kristalinë dhe fokuson imazhin si lentja e aparatit fotografik, duke e projektuar atë të kthyer përmbys. Mbasi fokusohet, imazhi shkon në retinë. Më pas përcillet në trurin tonë nëpërmjet nervit optik. Truri ynë e korrigjon imazhin duke e kthyer drejt atë (fig. 3).

Iluzionet optike

Ndonjëherë, ndodh që truri ynë e ka të vështirë t'i dallojë qartësisht disa imazhe. Truri përpiqet ta interpretojë informacionin që i vjen nga shqisat, duke e lidhur me përvojat e mëparshme, por ndihet i çorientuar. Kur imazhi nuk kuptohet në mënyrën e duhur, kemi të bëjmë me **iluzion optik**.


Vazo apo profil njeriu?

Gjatë përpunimit të imazhit është e rëndësishme të ndahet figura nga sfondi. Në rastin e dhënë, truri percepton dy imazhe: vazon, nëse vendos që sfondi është i bardhë dhe dy profile, nëse sfondi është i errët (fig. 4).



Të njëjta apo të ndryshme?


Të dyja tavolinat kanë të njëjtat përmasa, por për shkak të perspektivës që krijojnë nga mënyra se si janë vendosur, truri ynë përpiqet ta korrigjojë imazhin duke i paraqitur ndryshe (fig. 5).



Vija horizontale apo diagonale?


Të gjitha vijat janë të drejta. Shiritat e bardhë e të zinj nuk vijnë poshtë njëri-tjetrit në vijë të drejtë. Kjo gjë e bën trurin të mendojë se vijat horizontale janë të pjerrëta (fig. 6).

LUAJMË ME PERCEPTIMIN PAMOR




Zebër me dy koka?

Në shikim të parë duket një trup me dy koka. Vijat e zebërës dhe mbivendosja e figurave e ngatërrojnë trurin tonë, i cili nuk arrin t'i ndajë figurat nga njëra-tjetra. Gjej konturin e zebërës së parë dhe do të kuptosh pjesët e dukshme të zebërës së dytë (fig. 7).



Mace apo mi?


Në këtë figurë, truri ynë percepton figurën e maces, kur përqendrohet te njolla e zezë, ndërsa sfondin e sheh të bardhë. Por dallon figurën e bardhë të miut, kur njollën e zezë të maces e sheh si sfond (fig. 8).



Identifiko figurat e fshehura (fig. 9).



Sa kafshë ndodhen në këtë figurë: 4, 5 apo 6 (fig. 10)?




Identifiko figurën e fshehur (fig. 11).

SHENJA DHE PIKA

Shiko dhe diskuto

Në figurat e mëposhtme paraqiten disa shenja të shprehjes artistike. Përshkruaj karakteristikat e shenjave të ndryshme të paraqitura, duke u mbështetur edhe në përvojën tënde me teknikat e ndryshme artistike.



Shenjat grafike i gjejmë në një letër të vizatuar ose mbi sipërfaqen e materialeve të ndryshme.

Shenjat piktorike realizohen nga piktorët, shpesh nëpërmjet përdorimit të ngjyrës.

Shenjat plastike janë kryesisht të realizuara në reliev dhe kanë rëndësi të madhe për skulpturën. Këto shenja gjenden edhe në natyrë.

Shenjat arkitektonike janë të pranishme në fasada ose në brendësi të ndërtesave. Ato shfaqen në dekorime dhe në elemente që përsëriten.

Shenja

Shenja është shprehje e komunikimit të menjëhershëm të një mendimi ose të një gjendjeje shpirtërore. Shenja mund të jetë një fjalë, një tingull, një gjest, një gërricje mbi një material të fortë ose një vizatim në një letër. Shenjën mund ta shohim në pikën e bërë nga maja e një lapsi, në një pikë boje të lënë mbi letër, në gjurmën e aeroplanit në qiell, në gjurmët e këmbës mbi rrëzë ose baltë etj.


Pika

Pika konsiderohet si shenja ose forma më e vogël. Për ta bërë të dukshme, e paraqesim gjithmonë si një formë rrethore të vogël ose si një vrimë, por ajo mund të ketë edhe forma të tjera. Shumë pika të vendosura pranë njëra-tjetrës mund të krijojnë imazhe e figuracione që nga më të thjeshtat e deri tek ato më të ndërlikuarat.

Në varësi të mënyrës se si e përdorim pikën, ne mund të komunikojmë duke krijuar efekte të ndryshme me anë të saj. Kjo mënyrë ka të bëjë me madhësinë e pikës, me shpeshtësinë apo rrallësinë, me mjetin që përdorim, me presionin që ushtrojmë mbi të dhe me cilësinë e sipërfaqes mbi të cilën punojmë.

Bashkësi pikash lineare

Në këtë figurë, pikat në formën e dritave, të vendosura njëra pas tjetrës, krijojnë konturin e ndërtesës.



Bashkësi pikash që krijojnë formë


Ky është një kopsht ku dritat shfaqen si një bashkësi pikash, të cilat krijojnë format e një bimësie të larmishme.



Shumë nga gjërat në natyrë, shpesh na shfaqen në formë pikash, sidomos kur i shohim nga larg dhe kur janë të vendosura mbi një sipërfaqe njëngjyreshe. Shpesh, pikat tërheqin vëmendjen tonë për mënyrën se si bashkohen, herë duke krijuar konturin e formës e herë brendësinë e saj.

Në botën e kafshëve

Shohim pika me ngjyra të forta tek insektet (fig. 3), krahët e fluturës (fig. 4), pikat e verdha te zhapiku (fig. 5) ose pikat në lëkurën e leopardit të vogël (fig. 6).





Duke u mbështetur në vëzhgimet dhe njohuritë e tua, gjej shembuj të ndryshëm të mënyrës si paraqiten pikat në natyrë.



Në natyrë

Edhe në botën bimore, pikat shfaqen në forma të larmishme, si frutat e thara të kësaj bime (fig. 7). Zemrat e errëta të luleve të verdha shfaqen si një bashkësi pikash (fig. 8), po ashtu edhe vilet e rrushit, që e marrin formën nga një bashkësi pikash (fig. 9).





Në portretin e njeriut

Sytë janë ata që na tërheqin që në fillim në portretin e njeriut. Bebézat janë shembulli i dy pikave shumë të dukshme, sidomos te sytë që e kanë irisin në ngjyrë të çelët (fig. 10).

Yjet

Kur ndodhemi jashtë natën, na pëlqen të shohim qiellin e mbushur plot me pika të ndritshme. Ato janë yjet. Na tërheq mënyra se si grupohen dhe, shpesh, përpiqemi të krijojmë figuracione me to. Po ashtu, përpiqemi të gjejmë figuracionet e yjesive të ndryshme, si në figurë (fig. 11).



Ushtrime me pika

- Ndaj një letër në katrorë ose në figura të çrregullta.
- Secilën hapësirë, që ke krijuar, mbush me pika.
- Për çdo hapësirë, përdor një mjet të ndryshëm (lapsa me trashësi të ndryshme, flamastera me majë të hollë dhe të trashë, paste le etj.).
- Përsërit eksperimentin mbi një lloj tjetër sipërfaqeje, p.sh., mbi një pllakë plastelina.

Materialet

- Letër
- Laps, flamastera me madhësi të ndryshme
- Plastelinë

Çmo dhe vlerëso

- A do të kenë ndryshim nga njëra-tjetra hapësirat e ndara dhe pse? A ndikojnë madhësia e mjeteve dhe forca që ushtrojmë në këtë ndryshim? Po materiali i përdorur, a ndikon në cilësinë e pikës?



Piktura me pika

- Shiko me kujdes pikturën tradicionale me pika të popullsisë vendëse të Australisë dhe mënyrën e realizimit të saj (fig. c, fig. d).
- Vendos në qendrën e një letre figurën e thjeshtëzuar të një kafshe (ose të vizatuar, ose të prerë me letër punëdore).
- Përzgjidh deri në tri ngjyra dhe ndiq, me anë të pikëzimeve, siluetën e kafshës.
- Pasi ta mbarosh vijën e parë të pikave, përsërite të njëjtin veprim, por me ngjyrën tjetër. E kështu me radhë, derisa t'i kesh përdorur të gjitha ngjyrat njëzëri pas tjetres, si në figurë (fig. e).

Materialet

- Letër
- Bojëra të lëngshme (tempera ose akuarele)
- Një laps ose një shkop me trashësi sipas dëshirës

3.

VIJA

Shiko dhe diskuto

Shiko llojet e vijave që gjenden në peizazhin e mëposhtëm dhe jep shembuj të ndryshëm të llojeve të vijave në natyrë dhe në mjedisin përreth.

Vija e harkuar e ylberit

Vijat vertikale të shtyllave

Vija e valëzuar e pemëve



Vija diagonale e bregut




Në natyrë, mund të shikojmë lloje të ndryshme vijash. Në figurën e mësipërme, kemi: vijën e drejtë horizontale, një rrip toke që ndan qiellin dhe ujin; vijën e harkuar të ylberit që pasqyrohet në ujë; vijën diagonale të bregut, ku ndahet toka nga uji; vijat vertikale të shtyllave të drurit që mbajnë urën. Pemët në rripin e tokës, që ndan qiellin me ujin, krijojnë një linjë të valëzuar (fig. 1).

Vija përcjell ndjesi dhe gjendje të ndryshme shpirtërore. Nëpërmjet lëvizjes, drejtimit dhe trashësisë, ajo merr trajta të ndryshme. Duke parë se si shfaqet në hapësirë çdo vijë, mund të flasim për vija të drejta horizontale, vertikale, të pjerrëta, të ndërprera, zigzage, të harkuara, spirale dhe të valëzuara.


Vija horizontale komunikon ndjesinë e qetësisë. Shikojmë me kujdes vijën e horizontit që ndan qiellin me detin (fig. 2). Në pamjen ballore, shkallët paraqiten si vija horizontale (fig. 3).





Vija vertikale krijon një emocion qëndrueshmërie dhe tregon drejtimin për lart. Shikojmë bimët e bambusë të rreshtuara në linja vertikale dhe të qëndrueshme (fig. 4). Kulla e Sahatit ngrihet vertikalisht drejt qiellit duke treguar qëndrueshmëri (fig. 5).

Vija diagonale ndodhet në pozicionin midis vijës horizontale dhe vertikale. Kjo vijë krijon ndjesinë e lëvizjes dhe të paqëndrueshmërisë. Shikojmë me vëmendje vijën diagonale që krijon balerina në kërcimin e saj (fig. 6). Pema e rrëzuar, me trugun në drejtimin diagonal tregon paqëndrueshmëri (fig. 7).



Vija e ndërprerë është një vijë që krijon vazhdimësi duke marrë drejtime të ndryshme. Duke qenë një vijë e paqëndrueshme, ajo tregon lëvizje dhe është në ndryshim të vazhdueshëm. Shikojmë se si shfaqet kjo vijë në trupin e krimbit të mëndafshit, duke na treguar edhe lëvizjen e tij (fig. 8). Shohim vijën e ndërprerë që shoqëron bedenat e Murit të Madh Kinez. Ato tregojnë vazhdimësinë e këtij muri të gjatë (fig. 9).

Vija e shkallëzuar (zigzage)

është një vijë e ndërprerë dhe e bashkuar me kënde (të rregullta ose të çrregullta). Edhe kjo vijë tregon lëvizje dhe vazhdimësi.

Shikojmë konturin zigzag dhe ndjesinë e lëvizjes që na përcjell buza e gjetes (fig. 10). Vijën e shkallëzuar e shohim në profilin e shkallës (fig. 11).




Vija e harkuar dhe e valëzuar krijon efektin e një lëvizjeje të lehtë. Këtë e shohim te harqet e theksuara të petaleve të lules (fig. 12) dhe në lëvizjen e gjarprit (fig. 13).

Vija spirale tërheq vëmendjen me zhvillimin e saj nga brenda-jashtë si një lëvizje qendrore që vjen duke u zgjeruar. Këtë e kuptojmë më mirë, nëse shohim vijën spirale të guaska e kërmillit (fig. 14), të bimët e ndryshme (fig. 15), por edhe të shkallët spirale në arkitekturë (fig. 16).



Ushtrime me vija

- Vizato në qendër të fletës një vijë të valëzuar (fig. a).
- Sipër dhe poshtë saj, vizato vija të tjera që ndjekin të njëjtin ritëm të vijës së parë (fig. b).
- Mbushe në këtë mënyrë të gjithë faqen, për të krijuar një valëzim plastik (fig. c).




Materialet

- Letër
- Laps
- Flamaster

Peizazhi

Në fotografi, konturet e maleve krijojnë vija të shkallëzuara, që marrin drejtime të ndryshme (fig. d).

- Vizato konturin e hapësirave si te shembulli dhe mbushe çdo hapësirë me vija sipas formës që ato ndjekin në fotografi (fig. e).
- Përdor tonalitete ngjyrash të ndryshme për të vizatuar malet, duke filluar nga malet në plan të parë e deri tek ato të sfondit (fig. f).
- Për retë, mund të përdorësh vija të harkuara.



Materialet

- Letër
- Laps
- Flamaster



Çmo dhe vlerëso

- Shpjego llojet e vijave që përdore në krijimin tënd dhe mënyrën e realizimit të tyre.

FORMA DYDIMENSIONALE


Shiko dhe diskuto


Përshkruaj karakteristikat e formave në të dyja imazhet.



Forma është një vijë e mbyllur që rrethon një sipërfaqe. Format dydimensionale janë të sheshta, ato kanë gjerësi dhe gjatësi. Format mund t'i krijojmë jo vetëm nëpërmjet vijës, por edhe nëpërmjet vendosjes së ngjyrës mbi një sipërfaqe. Për lehtësi studimi, format i ndajmë në dy grupe: në forma natyrore dhe në forma gjeometrike (fig. 1, 2). Format natyrore janë ato me origjinë organike, si bimët, por edhe ato joorganike, si shkëmbinjtë, gurët etj. Shpesh, këto forma shfaqen të parregullta, por nuk mungojnë rastet kur ato janë të rregullta.

Format natyrore janë të larmishme në natyrë, duke filluar nga ato më të thjeshtat e deri tek ato më të ndërlikuarat (fig. 3, 4, 5).






Format gjeometrike elementare i gjejmë në natyrë. Shohim formën rrethore të portokallit (fig. 6), trekëndëshin te lulja (fig. 7), gjashtëkëndëshin te hojet e bletëve (fig. 8), katrorin te luspat e krokodilit (fig. 9).



Format e sakta gjeometrike i gjejmë kryesisht në objektet e krijuara nga njeriu, sidomos në arkitekturë (fig. 10). Tri format gjeometrike bazë janë rrethi, trekëndëshi dhe katrori. Të gjitha format e tjera burojnë prej tyre.



Shiko pikturën e Ibrahim Kodrës “Duke kërkuar idhuj të rinj”. Në të format gjeometrike e bëjnë më të dallueshëm personazhin kryesor nga personazhet e tjera të trajtuara me forma natyrore.



Shiko "Pikturën në blu" të Kandinskit (Kandinsky) dhe mënyrën se si i ka kombinuar ai format gjeometrike (fig. 12).





Shiko në pikturën "Kopshti i zogjve" të Pol Klesë (Paul Klee) format natyrore të zogjve dhe të bimëve me format gjeometrike të copëzave të murit të kopshtit (fig. 13).

VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet formës

Ushtrime me formën


Materialet

- Letër
- Laps
- Flamaster



Motive për qilim

- Shiko "Motive për qilim" të Xhakomo Balas (Giacomo Balla). Zbulo mënyrën se si zhvillohet vija dhe si krijon figura të ndryshme duke u mbivendosur. Shiko vijat dhe format e reja që janë krijuar (fig. a).
- Provo të vizatosh një imazh vetjak duke ndjekur të njëjtën rrugë. Më pas veço format nëpërmjet ngjyrosjes, sipas shembullit në fig. b.




Materialet

- Letër
- Laps
- Vizore
- Flamastera ose lapsa me ngjyra

Dekorim me figura gjeometrike

- Ndaje letrën e vizatimit në gjerësinë e saj, në shtatë rreshta të barabartë.
- Në rreshtin e parë, vizato katrorë.
- Në rreshtin e dytë, vizato trekëndësha me kulmin poshtë.
- Në rreshtin e tretë, poshtë kulmeve të trekëndëshave, vizato brinjët e katrorëve.
- Vazhdo në këtë mënyrë derisa të plotësohen të gjithë rreshtat.
- Ngjyrore dekorimin sipas dëshirës, duke bërë dallimin midis figurave gjeometrike që janë pranë njëra-tjetrës (fig. c).



Çmo dhe vlerëso

- A mund të krijosh edhe ti zbukurime të ndryshme duke kombinuar figurat gjeometrike?

A mendon se mund të krijohen zbukurime të shumëllojshme nëpër-mjet kombinimit të një ose dy figu-rave gjeometrike?

Shiko shembujt në fig. d, e.

Shiko dhe diskuto

Gjej ngjyrat në figurën e mëposhtme dhe dallo nuancat e tyre të ndryshme.




Për ta kuptuar dhe për ta përdorur ngjyrën si një mjet shprehës, duhet të njohim ligjet që e bëjnë këtë element pjesë të rëndësishme të gjuhës pamore.

Ne jetojmë në një botë plot me ngjyra. Nëse shikojmë me vëmendje mjedisin që na rrethon, mund të dallojmë një pafundësi tonalitetesh të ngjyrave (fig. 1).

Fizika na mëson se mund t'i perceptojmë ngjyrat nëpërmjet rrezeve të dritës, të cilat objektet i përthithin ose i përhapin.

Ajo që ne quajmë ngjyrë, nuk është gjë tjetër veçse rrezja e dritës e pasqyruar nga objekti.




Drita dhe ngjyra

Edhe pse e shohim të bardhë, në të vërtetë drita është e formuar nga një përzierje ngjyrash. Këtë mund ta zbulojmë nëpërmjet zbërthimit të dritës në spektrin e ngjyrave nga një prizëm qelqi (fig. 2).

Drita e diellit është një pjesë e vogël e këtij spektri dhe është pjesa e dukshme e tij. Një shembull tjetër i zbërthimit të dritës së diellit është edhe ylberi. Ngjyrat e tij krijohen nga drita, e cila përthyeret në pikat e shiut të përhapura në ajër. Ky fenomen ndodh mbas shiut ose afër ujëvarave.


Përse i shohim ngjyrat?

Kur drita godet një objekt, lënda nga e cila përbëhet objekti përthith një pjesë të rrezeve, kurse pjesën tjetër e përhap. Rrezet e përhapura nga objekti perceptohen nga syri ynë si ngjyra e objektit. Për shembull, një domate na shfaqet e kuqe pasi ka përthithur të gjitha rrezet e dritës, përveç të kuqes (fig. 3).



Ngjyrat e shumëllojshme janë të pranishme në natyrë dhe tek objektet e krijuara nga njeriu. Ndër to, ngjyra e verdhë, e kuqe dhe blu quhen ngjyrat bazë ose parësore, për arsye se nuk mund të krijohen nga përzierja e ngjyrave të tjera. Duke u përzier dy e nga dy, këto ngjyra krijojnë ngjyrat e dyta.

Rrethi i ngjyrave i Itenit



Për të njohur ngjyrat dhe për të kuptuar marrëdhëniet mes tyre është shumë e rëndësishme njohja me rrethin e ngjyrave të Itenit (fig. a). Johannes Itten ishte piktor që studioi teorinë e ngjyrave.

Në qendër të rrethit gjendet një trekëndësh barabrinjës ku janë të vendosura tri ngjyrat parësore: e verdha, e kuqja dhe bluja (fig. b). Çdo brinjë e trekëndëshit shërben si bazë e trekëndëshave dybrinjënjëshëm, ku në secilin prej tyre ndodhen ngjyrat e dyta (fig. c). Ndërsa në rrethin e madh vendosen edhe ngjyrat e treta, të cilat krijohen nga kombinimi i një ngjyre të parë dhe një ngjyre të dytë (fig. d).


Ngjyrat e ngrohta dhe ngjyrat e ftohta

Disa ngjyra të krijojnë ndjesinë e ngrohtësisë, pasi të kujtojnë diellin dhe zjarrin. Këto ngjyra janë e kuqja, portokallia, e verdha dhe quhen **ngjyra të ngrohta**.

Specat e kuq, të verdhë e portokalli (fig. 4); Lulet e kuqe (fig. 5); Kungujt (fig. 6)



Ngjyra të tjera të krijojnë një ndjesi të kundërt, atë të freskisë, pasi lidhen me ujin, akullin, hijet etj. Ngjyra të tilla janë bluja, jeshilja, vjollca dhe quhen **ngjyra të ftohta**.





Bluja në thellësi të detit (fig. 7); Gjelbërimi në natyrë (fig. 8); Lulet vjollcë që janë bërë si qilimi i pyllit (fig. 9).

VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet ngjyrës

Ushtrime me ngjyra

Ngjyrat e ylberit

- E kuqja, portokallia, e verdha, jeshilja, bluja dhe vjollca janë ngjyrat e ylberit.
- Krijë kompozime të ndryshme, si për shembull: peizazhe, lule, dekorime, duke e përdorur ngjyrën sipas renditjes tek ylberi.
- Fillo nga një formë e thjeshtë dhe në vazhdim krijë shiritat e ngjyrave. Shembujt e dhënë mund të të shërbejnë si një udhërrëfyes (fig. a, b).



Materialet

- Letër
- Laps
- Flamastera ose akuarele

Materialet

- Letër
- Laps
- Flamastera ose akuarele



Gjethja

Duke u nisur nga piktura “Gjethet” e Henri Matisit (Henry Matisse) (fig. c) dhe duke studiuar disa forma të ndryshme gjethesh, mund të krijosh kompozimet e tua origjinale.

- Vendosi gjethet në mënyrë të tillë që të ndërpresin njëra-tjetrën.
- Nëse ke vendosur një gjethe të verdhë që ndërpritet nga një gjethe e kuqe, pjesën e ndërprerë mund ta ngjyrosësh me ngjyrën e dytë. Në këtë mënyrë mund t'i përdorësh të gjitha ngjyrat e tjera me radhë (fig. d).

Çmo dhe vlerëso

- Shpjego mënyrën e kombinimit të ngjyrave në krijimin tënd dhe mënyrën e formimit të ngjyrave të dyta dhe të treta (rrethi i ngjyrave).

TEKSTURA

Shiko dhe diskuto

Çfarë e përcakton teksturën e sipërfaqes së çdo kutie në figurën e mëposhtme?

Në këtë fotografi,
bashkësia
e shenjave
karakteristike të
çdo erëze krijon
një teksturë të
veçantë (fig. 1).




Çdo element dhe objekt në natyrë, përveç lëndës që e përbën, ka edhe pjesën e jashtme, domethënë sipërfaqen. Ajo paraqet një cilësi të caktuar që quhet **teksturë**. Tekstura kuptohet si nëpërmjet të parit, ashtu edhe nëpërmjet të prekurit. Për shembull, kur prekim mollën, kemi një ndjesi tjetër nga ajo që përftojmë kur prekim trungun e ashpër të pemës së mollës. Në këtë mënyrë, mund të dallojmë karakteristikat e çdo **teksture**, që është një **bashkësi shenjash, formash, ngjyrash e vijash** dhe që përcakton edhe pamjen e jashtme të objekteve.

Çdo material mund të punohet në mënyra të ndryshme për t'i dhënë karakteristika të veçanta sipërfaqes së jashtme.

Tekstura natyrore

Teksturat e para që njohim janë pikërisht ato natyroret, që i gjejmë tek objektet në natyrë. Po të shikojmë me kujdes lëvoren e pemëve, do të zbulojmë shumëllojshmëri teksturash. Disa pemë e kanë lëvoren të lëmuar, disa të ashpër, disa poroze etj. Po ashtu, edhe gjethet kanë tekstura të ndryshme. Kafshët kanë lloje të ndryshme lëkurash, puplash apo luspash.



Pemë me tekstura të ndryshme (fig. 2, 3, 4).



Kur janë në bashkësi, gjethet formojnë tekstura të larmishme (fig. 5, 6, 7), por edhe teksturat e vetë gjethëve ndryshojnë nga njëra-tjetra (fig. 8, 9, 10).



*Tekstura e puplave të palloit (fig. 11).
Tekstura e zhguallit të breshkës (fig. 12).
Tekstura e puplave të papagallit (fig. 13).*



Tekstura artificiale

Në jetën tonë të përditshme, jemi të rrethuar nga objekte të ndryshme të prodhuara nga dora e njeriut. Të gjitha këto objekte paraqiten me një larmi të madhe teksturash. Shikojmë me vëmendje teksturën e mureve, të fasadave të ndërtesave, të pllakave të trotuareve etj. Në mjediset e brendshme, të gjitha objektet shfaqen me tekstura të shumëllojshme, si: divanet, mobiliat, jastëkët, perdet, qilimi, veshjet e shumë objekte të tjera të përdorimit të përditshëm.



Mur prej guri (fig. 14)



Pllaka (fig. 15)

Tekstura e stolit e krijuar nga bashkimi i kallamave të bambusë (fig. 16).



Objekte të përdorimit të përditshëm kanë tekstura të ndryshme në varësi të materialit të përdorur dhe të përpunimit të tij (fig. 17).




Format e ndryshme të punimit të tekstileve bëjnë që ato të shfaqen me tekstura të shumëllojshme (fig. 18).



Vazo me teksturë të veçantë (fig. 19)

VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet teksturës

Ushtrime me teksturën



Materialet

- Letër
- Laps
- Rapidograf

Tekstura gjethesh

- Vizato një gjethe të madhe e më pas vendos nervin kryesor dhe zgjatimet e tij anësore.
- Hapësirat e ndara të gjethes vizatoji me nga një teksturë të ndryshme, duke e marrë idenë nga imazhet në libër (fig. a, b).
- Këtë provë mund ta realizosh edhe duke e ndarë letrën në forma të tjera dhe duke vizatuar më pas tekstura të ndryshme në çdo hapësirë.



Bufi

- Shiko me vëmendje bufin në fotografinë nga natyra (fig. c), në imazhin e vizatuar (fig. d) dhe në skulpturë (fig. e).
- Krijo edhe ti teksturën e bufit në vizatimin tënd ose zgjidh një shpend tjetër me teksturë të veçantë.

Materialet

- Letër
- Laps
- Lapsa me ngjyra

Çmo dhe vlerëso

- Shpjego mënyrën e realizimit të teksturës në krijimin tënd dhe shenjat që përdore.

7.

VËLLIMI

Shiko dhe diskuto

Përshkruaj ngjyrat, format e frutave në imazh dhe gjej zonat me dritë dhe hije. A mund të shquajë formë dhe ngjyrë syri ynë atje ku drita nuk hyn? Pse?



- Në fotografi shohim shumë qartë ngjyrën dhe formën e frutave.
- Shohim qartë edhe formën e tyre në zonën e hijes.
- Ndërsa në thellësi, aty ku drita nuk hyn, syri ynë nuk mund të shohë.

Drita i bën të dukshme për sytë tanë sipërfaqet, ngjyrat dhe vëllimin e objekteve.

Drita është një formë energjie që buron nga dielli ose nga burime të tjera, siç janë llambat elektrike. Dritën që buron nga dielli e quajmë dritë natyrore, ndërsa dritë artificiale quajmë atë që vjen nga burimet e tjera.

Në komunikimin pamor, njohja e burimit dhe e efekteve që prodhon drita na bën të mundur mbledhjen e informacionit të duhur për ta njohur dhe për ta riprodhuar realitetin (fig. 1).

Drita dhe hija

Drita na bën të mundur perceptimin e ngjyrës së një objekti, perceptimin e formës dhe të vëllimit të tij nëpërmjet dritëhijes.

Shikojmë dhe krahasojmë dy fotografi, njëra e realizuar në një çast me diell, kurse tjetra në një mot gri dimri.




Në fotografinë e parë, do shohim se ngjyrat janë të ndritshme. Faqet e ndërtesës ndahen në faqen e ndriçuar dhe në faqen në hije. Këtu ndihet kontrasti i fortë midis zonave të ndriçuara dhe atyre të pandriçuara, i cili i jep edhe vëllim objektit. Në këtë fotografi, shohim edhe hijen që lëshon ndërtesa mbi tokë (fig. 2).



Në fotografinë e dytë, ngjyrat janë të shuara. Nuk kemi kontrast dhe ndërtesa duket si e sheshtë dhe pa vëllim (fig. 3).

Hija e objektit

Hija e mbartur



Hija e objektit dhe hija e mbartur

Drita lëviz në vijë të drejtë dhe, kur takon një objekt, e ndriçon atë. Pjesa tjetër e objektit qëndron në hije. Kjo hije, që prodhohet mbi sipërfaqen e objektit në zonën e pandriçuar dhe që thekson konturin e tij, quhet **hije e objektit**. Ndërsa hija që objekti lëshon mbi sipërfaqen ku është mbështetur quhet **hije e mbartur** (fig. 4).

5




6



Gjej hijen e mbartur dhe hijen e objektit te fotografitë e mësipërme.

VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet vëllimit




Krijo hijen 1

- Prit imazhin e një objekti të marrë nga një revistë dhe ngjite mbi një fletë vizatimi. Krijo mjedisin përreth objektit përmes kolazhit ose vizatimit (fig. a).
- Shiko me kujdes cili është burimi i dritës në figurën që ke prerë nga revista dhe vizato hijen e mbartur që formohet mbi mjedisin që ke krijuar (fig. b).

Materialet

- Letër
- Laps, Flamaster
- Ngjitës
- Fletë revistash



Krijo hijen 2

- Krijo një vizatim me pak elemente dhe vendos mbrapa objekteve të vizatuara një pikë, që tregon burimin e dritës.
- Nga pika, që shërben si burim drite, hiq një vijë drejt objektit duke e kaluar atë dhe duke krijuar kështoj hijen e mbartur (fig. c, d).
- Në këtë mënyrë mund të krijosh kompozime pa fund, duke u frymëzuar nga ambienti që të rrethon.

Materialet

- Letër
- Laps
- Flamastera apo akuarele

Çmo dhe vlerëso

- Shpjego mënyrën e realizimit të hijes së mbartur dhe të hijes së objektit në krijim.

Shiko dhe diskuto

Shpjego karakteristikat e dy hapësirave të paraqitura në imazhet e mëposhtme. Jep shembuj të hapësirave të ndryshme.

Hapësira e brendshme është ajo hapësirë që kufizohet nga muret, nga shkallët, nga mobili (fig. 1).



Hapësira e jashtme ndahet në dy lloje: në hapësirën urbane ose natyrore me thellësi të mesme dhe në hapësirën natyrore.

Shikojmë me vëmendje fotografinë që na tregon një hapësirë qyteti, ku ndërtesat dhe objektet përreth na pengojnë të shohim shumë larg (fig. 2).



Jeta jonë zhvillohet në hapësirë, ku njerëzit, kafshët, objektet tregojnë karakteristikat e tyre të formave, të vëllimit, të ngjyrës dhe të teksturës. Kjo hapësirë ka tri përmasa: gjerësinë, gjatësinë dhe thellësinë. Këto përmasa i kanë të gjitha objektet që bëjnë pjesë në këtë hapësirë. Çdo trup, sa më shumë largohet nga syri ynë, aq më i vogël shfaqet në përmasa; ai mund të mbulohet pjesërisht nga trupa që syri i ka më afër.

Ne e perceptojmë hapësirën e brendshme të mbyllur dhe hapësirën e jashtme të hapur.



Kur ndodhemi brenda një pylli plot me pemë, vështrimi ynë nuk mund të shkojë larg (fig. 3).




Hapësira natyrale e hapur na ofron mundësinë që vështrimi ynë të shtrihet shumë larg, te qielli, te malet, te vija e horizontit. Kjo hapësirë mund të jetë e pafundme (fig. 4).

Aftësia jonë për ta kuptuar hapësirën është e lidhur me mënyrën se si trupi ynë përshtatet me lartësinë, gjerësinë dhe thellësinë. Marrëdhënie të tilla si: sipër, poshtë, përpara, mbrapa, afër dhe larg lindin nga përvoja jonë trupore. Në jetën tonë të përditshme, krijojmë një marrëdhënie hapësinore midis nesh dhe objekteve, ashtu si edhe midis vetë objekteve.



Skulpturë parku, Joan Miro




"Rrezet e diellit poshtë plepave", Klod Moné (Claude Monet)

Në artin pamor, në skulpturë dhe në arkitekturë, marrëdhënien hapësinore e shprehim nëpërmjet objekteve me tri përmasa (fig. 5), kurse në pikturë atë e shprehim me dy përmasa (lartësinë dhe gjerësinë) (fig. 6).

Për të paraqitur hapësirën në një sipërfaqe me dy përmasa, përdorim treguesit hapësinorë.

Thellësinë mund ta shprehim nëpërmjet **zvogëlimit të madhësisë së objekteve dhe të distancës** midis tyre. Këtë e shohim te varkat në anë të detit (fig. 7), te harqet e një ndërtese (fig. 8) apo te kolonat e një ure të gjatë (fig. 9).





Objektet që kemi **afër**, edhe pse të vogla, duken më të mëdha sesa ato që janë **larg**. Shohim figurën ku shapkat duken shumë më të mëdha se pemët apo njerëzit që janë larg. Kjo është një mënyrë shumë e mirë për të paraqitur thellësinë (fig. 10).



Mbivendosja e objekteve është një mënyrë për të shprehur hapësirën. Kur objekti që kemi përpara fsheh atë që vjen mbrapa tij, e kështu me radhë, nga përvoja kuptojmë se kjo tregon thellësi (fig. 11, 12).

VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet hapësirës

Ushtrime me treguesit hapësinorë





Materialet

- Letër
- Laps
- Flamastera ose akuarele

Ndjesia e hapësirës në një vizatim ose pikturë mund të krijohet si nëpërmjet përmasave të përdorura, ashtu edhe nëpërmjet ngjyrës.

- Provo ta krijosh edhe ti këtë efekt duke përdorur forma të thjeshta.
- Mund të përdorësh figura gjeometrike ose forma të çrregullta, duke i vizatuar në fillim me përmasa të mëdha dhe pastaj duke i zvogëluar gradualisht, rresht pas rreshti.
- Edhe ngjyrën vendose të fortë në fillim dhe zbehe gradualisht me zvogëlimin e figurave.

Një mbi një dritaret



Materialet

- Letër
- Laps
- Flamastera ose rapidograf

- Duke u nisur nga një imazh i qytetit të Beratit të quajtur ndryshe “Qyteti i një mbi një dritareve”, ku shtëpitë janë të vendosura njëra mbi tjetrën, krijo një peizazh duke përdorur treguesin hapësinor të mbivendosjes (fig. c, d).
- Treguesit hapësinorë të ndihmojnë për të krijuar thellësi në punimet e tua.

Çmo dhe vlerëso

- Diskuto mbi mënyrat e ndryshme të paraqitjes së hapësirës. Shpjego mënyrën e paraqitjes së hapësirës që përdore.

KOMPOZIMI DHE PARIMET E TIJ

Shiko dhe diskuto

Çfarë na bie në sy kur shikojmë imazhin e paraqitur në këtë faqe?

Shikojmë shpërndarjen e elementeve. Atë që shfaqet në anën e djathtë deri në qendër të imazhit e shohim të përsëritur, në të majtë të tij, gati si reflektim. Për këtë arsye, ky imazh quhet **i baraspeshuar** në mënyrë simetrike.

Dritaret e shtëpisë përsëriten duke krijuar kështu një **ritëm** mbi sipërfaqe. Ngjyrat e përafërta, në tonalitetet e grisë, së bashku me dritaret e shpërndara në mënyrë ritmike krijojnë **harmoni**. Ngjyra e errët e bimësisë dhe e dritareve krijojnë **kontrast** me bardhësinë e ndërtesës, duke e bërë atë të bjerë më shumë në sy. Dritaret e ndërtesës janë në **proporcione** të rregullta si me njëra-tjetrën, ashtu edhe me të gjithë ndërtesën.



Vëzhgimi i kujdesshëm na mundëson të analizojmë kompozimin e imazhit, pra organizimin e elementeve që e përbëjnë ose **parimet** (rregullat) e **kompozimit**.


Njohja me parimet e kompozimit na ndihmon të kuptojmë dhe të përdorim proceset që udhëheqin vëmendjen tonë për të kuptuar mesazhet domethënëse të imazheve.

BARASPESHA

Shiko imazhin e fluturës dhe gjej shembuj të ndryshëm të simetrisë.

Krahët
simetrikë të
fluturës

Aksi i
simetrisë





1

Format e rregullta në natyrë janë ato që i kuptojmë dhe i kujtojmë më me lehtësi sesa format e çrregullta. Në natyrë, format simetrike përfaqësojnë një shembull të rregullit gjeometrik mbi të cilin janë formuar strukturat e gjalla organike dhe ato joorganike. Shembulli i parë i simetrisë, që na vjen menjëherë në mendje, është flutura (fig. 1).

Baraspesha në një objekt ose në një kompozim karakterizohet nga **simetria** atëherë kur elementet që e formojnë atë janë të njëllajta në të dyja anët e **aksit të simetrisë**. Imazhi që shikojmë na përcjell një ndjesi qetësie, harmonie dhe ekuilibri.



Një lloj tjetër i simetrisë është edhe **simetria rrethore**. Edhe në këtë rast, të gjitha anët e objektit janë të barabarta, por tashmë i referohen pikës së simetrisë që përkon edhe me qendrën e rrethit.

Ndërsa, kur dy anët e një objekti apo imazhi janë të ndryshme, duke iu referuar aksit të tyre, kemi të bëjmë me një baraspeshë **asimetrike**.



Simetria

Shikojmë me vëmendje format e gjethëve (fig. 2), trupin dhe portretin e njeriut (fig. 3), zebrën (fig. 4) etj., si shembuj të simetrisë. Te këto figura, shohim pasqyrimin e njëres anë te tjetra, si në një pasqyrë.





Këtë simetri mund ta shohim edhe në imazhe të ndryshme, si në ato natyrore, si edhe në ato të ndërtuara nga dora e njeriut (fig. 5, 6), kryesisht në arkitekturë (fig. 7).

Simetria rrethore


Simetria rrethore është lehtësisht e dukshme në natyrë. Atë e gjejmë te lulet, ku petalet sillen rreth qendrës së simetrisë, për të formuar rrethin (fig. 8). Shembull i kësaj simetrie janë edhe kristalet e dëborës.

Kjo lloj simetrie është përdorur nga njerëzit në krijimet e tyre. Të tilla janë rozetat e kishave gotike (fig. 9), dantellat rrethore që përdoren nga amvisat për zbukurim, pjatat e dekoruara të qeramikës (fig. 10).




Asimetria

Natyra na ofron shembuj të ndryshëm të asimetrisë.



Një pemë shpesh shfaqet asimetrike, si te trungu, ashtu edhe te kurora e degëzimet e saj (fig. 11). Kjo gaforre e ka njërin prej grepave më të zhvilluar se tjetrin (fig. 12). Asimetria përdoret në arkitekturë (fig. 13) dhe në dizajn, si: veshje, bizhuteri (fig. 14).

VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet simetrisë




Materialet

- Revista ose letra me ngjyra
- Laps
- Gërshërë
- Flamastera ose akuarele

Kolazhi simetrik

Objektet ose imazhet simetrike shpesh na japin idenë e një pasqyrimi identik, si në një pasqyrë. Këtë e gjë e shohim në natyrë në dukurinë e pasqyrimin në ujë (fig. 5, faqe 40).

- Vizato aksin e simetrisë në mënyrë horizontale, ku pjesa e poshtme do të jetë ajo e pasqyrimin.
- Prit forma objekteve me letra me ngjyra ose nga revista, të njëjta si për pjesën e sipërme ashtu edhe për të poshtmen.
- Ngjiti në letër duke krijuar pasqyrimin. (Për pjesën e pasqyruar mund të përdorësh edhe mjetet e vizatimit) (fig. a, b).



Simetria rrethore

Pjatat e pikturuara, dantellat e gjysheve, kristalet e dëborës janë shembuj shumë të mirë për të realizuar një punim me simetri rrethore.

- Palos në katër pjesë një letër me ngjyrë në formë katrore.
- Vizato motivin si në figurë dhe prit me gërshërë pjesët që nuk duhen (fig. c, d).
- Realizo edhe një fletë me ngjyrë tjetër në të njëjtën mënyrë.
- Bashkoi në qendër të dyja format e përfutuara. Në këtë mënyrë, mund të krijosh një rozetë dyngjyrëshe, apo edhe me më shumë (fig. e).

Materialet

- Letra me ngjyra
- Laps
- Gërshërë

Çmo dhe vlerëso


- Diskuto mbi llojet e ndryshme të baraspeshës. Shpjego mënyrën e realizimit të simetrisë në krijimin tënd.

10.


RITMI DHE HARMONIA

Shiko dhe diskuto

Ndiq me vëmendje lëvizjet që bën vajza që kërcen me litar. A përsëriten lëvizjet e saj në mënyrë ritmike?



Ritmin e gjejmë në veprimet tona të përditshme. Gjatë frymëmarrjes, gjoksi ynë ulet e ngrihet në intervale të rregullta. Zemra na rreh në mënyrë të rregullt si një orë. Ritmin e gjejmë në natyrë, gjithashtu: lindja e diellit dhe perëndimi i tij, dita dhe nata, stinët etj. Përsëritja e rregullt e dy fenomeneve, dy tingujve, e lëvizjeve etj., krijojnë ritmin. Ritmi ka një zhvillim të rregullt edhe kur është i thjeshtë, edhe kur është i ndërlikuar.



Krahët e zogjve në fluturim ndjekin një ritëm shumë të saktë. Kështu bën edhe atleti kur vrapon apo notari kur noton. Intervali është pushimi midis dy pozicioneve ose midis dy imazheve.



Ritmi në artin dekorativ

Në artin dekorativ, në zbukurimet e një tekstili ku përsëritja e motivit është e nevojshme, ritmi është mjaft i rëndësishëm për të dhënë një paraqitje të rregullt dhe të pëlqyeshme.

Në figurën 5 paraqitet përparësja e një veshjeje popullore shqiptare. Fashat me motive të njëjta përsëriten në mënyrë të rregullt.



Motive ritmike të veshjes popullore shqiptare

Motiv egjiptian



Zbukurimet në qytetërimin antik egjiptian shprehin një ndjenjë të theksuar ritmike në figuracionet e tyre të stilizuara (fig. 6).

Etruskët kanë lënë dëshmi të shumta të imazheve ritmike në pikturën e varreve (fig. 7).

Motiv ritmik nga një varr etrusk

Harmonia ritmike

Harmonia në një vepër arti krijohet kur të gjitha elementet e artit (vija, forma, ngjyra, tekstura lidhen dhe plotësojnë njëra-tjetrën). Përsëritja e tyre në një ritëm të caktuar është një mënyrë e mirë për të arritur harmoninë në një vepër arti.

VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet ritmit

Shiko me vëmendje zbukurimet e tekstileve popullore (fig. 9). Ato janë të pasura në motive dhe në zhvillimin e ritmit. Vetëm me një motiv, sado i thjeshtë të jetë ai, mund të krijohen zbukurime të shumëllojshme me harmoni ritmike.



Realizo edhe ti një motiv ritmik duke përdorur teknikën e shtypit:




- Në fillim zgjidh motivin popullor, sipas dëshirës.
- Vizatoje në një karton dhe prite me gërshërë (fig. a).
- Përzgjidh, një, dy ose tri ngjyra.
- Lyej motivin me ngjyrën e zgjedhur dhe përhape duke e shtypur mbi letër (fig. b).
- Krijë një ritëm sipas dëshirës. Mos harro përsëritjen me intervale të caktuara të ngjyrave që ke zgjedhur (fig. c, d).

Materialet

- Karton
- Laps
- Gërshërë
- Ngjyra uji (tempera).

Çmo dhe vlerëso

- Shpjego mënyrën e realizimit të ritmit nëpërmjet motivit të zgjedhur.



11.


KONTRASTI

Shiko dhe diskuto

Bëj dallimin midis frutave të manaferrës në figurën 1. Krahase ngjyrën dhe madhësinë e tyre. A mund të themi që manaferra e zezë krijon kontrast me manaferrat e kuqe?

Kur themi kontrast mendojmë krahasimin midis dy objekteve ose fenomeneve.

Kontrastin e gjejmë në natyrë: dita dhe nata (fig. 2), e ngrohta dhe e ftohta, lulet e kuqe në një fushë të gjelbër (fig. 3), lumi dhe përroi, pemë dhe shkurre (fig. 4), drita dhe hija (fig. 5), etj. Kontrastin e gjejmë në mjedisin rrethues: ndërtesë e madhe, ndërtesë e vogël; e re, e vjetër; e hollë, e trashë; e bukur, e shëmtuar etj.



Kontrasti është një nga parimet e kompozimit. Mënyra kryesore për të krijuar kontrastin është nëpërmjet përdorimit të llojeve të ndryshme të vijave, të formave, të ngjyrave, të teksturave, të përmasave etj. Artistët e përdorin kontrastin në veprat e tyre për të dhënë një mesazh të caktuar.



Fig. 6. Viktor Vasarely (Victor Vasarely), Ndashja, 1945

Artisti ka përdorur kontrastin grafik të bardhë e zisë në veprën e tij.




Fig. 7. Van Gogh, Kafeneja, 1888

Në këtë vepër, artisti ka përdorur kontrastin midis ngjyrës së ftohtë blu të natës dhe ngjyrës së ngrohtë të dritës elektrike të kafenesë.



Fig. 8. Klaus Oldenbërg (Claes Oldenburg), Koshi van Bryhen (Coosje van Bruggen), "Ura-lugë dhe qershia", 1985-1988

Artistët kanë përdorur shkallën e proporcioneve për të krijuar kontrastin. Luga dhe qershia janë krijuar në një shkallë monumentale, gjë që krijon kontrast me mjedisin përreth, duke u nisur nga përmasat e tyre si objekte të jetës reale.

VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet kontrastit

Shiko kompozimin me zogj të artistit Gjelo Gjokaj dhe mënyrën se si e ka krijuar kontrastin. Artisti ka përdorur kontrastin grafik midis të errëtës së zogjve dhe ngjyrës së çelët të sfondit.



- Përzgjidh edhe ti një kafshë të parapëlqyer për kompozimin tënd.
- Vizatoje me laps mbi letër.
- Përdor raportin grafik të bardhë e zisë midis sfondit dhe figurës (ose shoqëroje të zezën me një ngjyrë tjetër çfarëdo).
- Zgjidhe sipas dëshirës teknikën për të realizuar punimin tënd (flamastera, pastelev ose ngjyra uji).
- Shembujt në libër tregojnë për mënyrat e ndryshme të raportit të kontrastit bardhë e zi midis sfondit dhe figurës (fig. a, b, c).



Materialet

- Sipas dëshirës

Çmo dhe vlerëso

- Shpjego mënyrën e realizimit të kontrastit në punën tende dhe mjetet që zgjodhe.


12.

PROPORCIONET

Shiko dhe diskuto

Në figurën 1 jepen dy topa tenisi. Si paraqiten përmasat e tyre në marrëdhënie me njëra-tjetrën? A kanë të njëjtën masë topat e tenisit që ne përdorim?

Në jetën reale proporcionet (përmasat) midis topave të tenisit janë të barabarta, ndërsa në imazh ato shfaqen me shkallë të ndryshme.





Proporcioni në kompozim është marrëdhënia midis dy ose më shumë objekteve. Proporcionet e sakta marrin shumë rëndësi në një vepër ku imazhi shfaqet realist. Në natyrën e qetë të Zef Kolombit (fig. 2), objektet në tavolinë shfaqen në proporcione reale në lidhje me njëra-tjetrën. Në të njëjtën mënyrë shfaqen edhe proporcionet brenda çdo objekti.

Skulptura e Mikelanxhelos “Davidi” është një vepër që thekson proporcionet ideale të trupit të njeriut dhe të portretit.


Mikelanxhelo (Michelangelo), Davidi, mermer, 1501-1504



Proporcionet i referohen edhe marrëdhënies së një pjese me të tërën. Kur flasim për proporcionet e trupit të njeriut i referohemi marrëdhënies që krijojnë pjesët e ndryshme të portretit me portretin apo edhe vetë portreti me të gjithë trupin (fig. 4, 5).



Ndryshimi i proporcioneve mund të ndodhë edhe prej mënyrës se si i shohim ne gjërat. Proporcionet e ndryshuara përdoren për të krijuar imazhe imagjinare, si në pikturën e Rene Magritit (fig. 6) ose për të krijuar kontrast në kompozim për një qëllim të caktuar, si p.sh.: Në figurën 7 vajza është bërë sa përmasat e murit dhe krijon kontrast me pemën reale që duket sikur po e ujit.




Rene Magrit (Rene Magritte)



Natalie Rak, Pikturë murale

VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet proporcionit

Shiko ilustrimin e përrallës “Liza në botën e çudirave”. Ilustruesi ka përdorur ndryshimin e proporcioneve për të krijuar botën imagjinare të Lizës, duke e zmadhuar atë shumë më tepër se dhoma.



Krijo edhe ti një kompozim imagjinar ose që krijon humor, nëpërmjet ndryshimit të qëllimshëm të proporcioneve (fig. a, b).

Materialet

• Sipas dëshirës



Çmo dhe vlerëso

• Shpjego mënyrën e përdorimit të proporcioneve në krijimin tënd dhe rëndësinë që kanë proporcionet e rregullta në imazhet realiste.




VERIFIKO NJOHURITË MBI GJUHËN ARTISTIKE

Përgjigju pyetjeve:

Shko në faqen përkatëse
për të vërtetuar përgjigjen:

▶ 1. Shenja më e vogël e gjuhës pamore është: ☐ Vija ☐ Ngjyra ☐ Pika ☐ Drita	10
▶ 2. Jep shembuj të llojeve të vijave në natyrë.	14-16
▶ 3. Cilat janë dy mënyrat për të kuptuar teksturën?	26
▶ 4. Plotëso mendimin: Format në natyrë i ndajmë në _____ dhe _____	18-19
▶ 5. Cilat janë ngjyrat e ngrohta dhe ngjyrat e ftohta? Shpjego karakteristikat e tyre.	22-24
▶ 6. Shiko figurat me kujdes për të gjetur hijen e mbartur, hijen e objektit dhe burimin e dritës, duke i lidhur me shigjetë.	30-32



- Hijen e mbartur
- Hijen e objektit
- Burimin e dritës



▶ 7. Në sa lloje e ndajmë hapësirën dhe cilat janë ato?	34-36
▶ 8. Cilat janë tri llojet e baraspeshës?	39-41
▶ 9. Si krijohet ritmi?	43-44
▶ 10. Plotëso mendimin: Përsëritja e _____ (vijës, formës, ngjyrës, teksturës) në një ritëm të caktuar është një mënyrë e mirë për të arritur _____ në një vepër arti.	44
▶ 11. Jep shembuj të kontrastit nga jeta e përditshme dhe trego si mund të krijohet kontrasti në një vepër arti.	47
▶ 12. Çfarë proporcionesh duhet të përdorim për të krijuar një imazh realist?	49-50

☐ a. Të rregullta

☐ b. Të çrregullta

KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

Realizimi i ideve nëpërmjet teknikave dhe proceseve të larmishme artistike

Fjala “teknikë” përfshin rregullat dhe metodat që përdoren në pikturë, skulpturë, arkitekturë dhe shumë procese krijuese. Përdorimi i materialeve specifike merr shumë rëndësi në këto veprimtari.

Çdo teknikë artistike ka materialet dhe mjetet specifike, që e dallojnë nga të tjerat. Gjithashtu, çdo teknikë është e veçantë edhe për sa u përket rregullave që ndiqen për përdorimin e këtyre mjeteve dhe materialeve.

Kjo tematikë jep informacionin bazë mbi teknikat që mund të përdoren në mënyrë të pavarur. Çdo teknikë është e shoqëruar me veprimtari praktike, që mund të zhvillohen më tej.

Në këtë tematikë, do të shohim edhe lidhjet midis teknikave dypërmasore si vizatimi, piktura, mozaiku, teknikave grafike të shtypit dhe teknikave trepërmasore, siç janë ato të modelimit në skulpturë dhe të konstruksionit në arkitekturë.

Dizajni dhe fotografia janë forma teknologjie artistike bashkëkohore. Ato ofrojnë mundësi të shumta shprehëse, duke bashkëpunuar ngushtë me teknikat tradicionale.

Mësimet 1-8

Njohuritë:

- vizatimi, akuareli, mozaiku, shtypi (stampimi), fotografia, grafik dizajni, skulptura, konstruksioni.



Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/jja:

- **zbulon** karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike;
- **përdor** me kompetencë mjetet dhe teknikat në realizimin e punimeve artistike;
- **organizon** gjuhën pamore nëpërmjet mundësive shprehëse të teknikave të ndryshme artistike;
- **shpreh** idetë në mënyrë vetjake dhe origjinale duke përdorur teknika artistike të larmishme.


VIZATIMI

Vizatimi është teknika më e shpejtë për të shprehur mendimin dhe për të komunikuar përmes imazhit. Vizatimi realizohet duke përdorur elementet e gjuhës pamore, si pikat dhe vijat. Nëpërmjet tyre, paraqiten **format** e një **figure** ose të një **objekti** (fig. 1). Zakonisht, vizatimi nëpërmjet vijës përcakton konturet e objektit (fig. 2).



Vizatimi realizohet me mjete të ndryshme. Lapsi dhe karboni janë mjetet më praktike për të vizatuar.

Lapsi është një cilindër i gjatë që përfundon me majë të mprehtë. Maja e lapsit është një përzierje e pluhurit të **grafitit** (mineral me ngjyrë gri të errët) dhe e argjilës, që vishet nga një mbështjellëse druri. Maja është ajo që lë shenjën gri mbi sipërfaqe (fig. 3).




Lapsat janë të llojeve të ndryshme në varësi të përbërjes së tyre dhe të mënyrës së pjekjes. Si rezultat i kësaj, shenja që ata lënë mbi letër është e ndryshme. Disa lënë një **shenjë të lehtë**, disa lënë një **shenjë më të fortë**. Shenja që lë lapsi mbi letër mund të fshihet lehtësisht nga goma. Kjo gjë e bën këtë teknikë shumë të përdorshme dhe shumë të lehtë për të eksperimentuar (fig. 3).

Letra është një tjetër mjet i rëndësishëm në teknikën e vizatimit. Në varësi të letrës që përdorim, të pastër ose me pore, mund të krijojmë efekte të ndryshme në vizatim (fig. 4).

Këtë mund ta kuptojmë duke eksperimentuar si me lapsa, si edhe me letra të ndryshme.



VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet teknikës së vizatimit



Shkallëzime tonale

- Shiko shkallëzimet tonale në figurë.
- Duke përdorur lapsa me butësi të ndryshme, realizo edhe ti shkallëzime tonale në fletoren tënde.

Materialet

- Karton
- Laps


Çmo dhe vlerëso

- Diskuto se si cilësia e shenjës së lapsit mbi letër varet edhe nga presioni që ushtrojmë mbi lapsin. Duke njohur mundësitë shprehëse të lapsit, mund të krijohen shkallëzime tonale të ndryshme.

Peizazh



- Shiko me vëmendje vizatimin e artistit Dejvid Hokni (David Hockney). Shiko se si i përdor ai shkallëzimet tonale të lapsit për planet e vizatimit. Më pas, shiko mënyrën si e përdor presionin e dorës për të vizatuar pemët dhe degët e tyre (fig. b).



- Realizo edhe ti një peizazh duke ndjekur hapat e mëposhtëm. Në fillim, ndajni planet e peizazhit me vijë. Përdor shkallëzimet e grisë për planet e krijuara (fig. c). Vizato pemët (ose objektet) në peizazh, duke bërë dallimin midis degëve dhe trungut, si dhe midis llojeve të pemëve.


Të pikturosh do të thotë të realizosh imazhe me ngjyra mbi një sipërfaqe të sheshtë. Sipërfaqja e sheshtë mund të jetë letër, karton, telajo mbi të cilat pikturohet me materiale të ndryshme. Në këto sipërfaqe, mund të realizohen imazhe duke përdorur teknika të ndryshme të pikturës.

Akuareli

Akuareli është një teknikë që ka për bazë ujin. Ngjyrat e akuarelit krijohen nga pigmentet e ngjyrës, gomës arabike dhe ujit. Akuarelet janë ngjyra transparente (fig. 1).

Në këtë teknikë është e rëndësishme që të jemi të sigurt kur e vendosim ngjyrën mbi letër, pasi nuk kemi mundësi korrigjimi. Puna fillohet nga tonalitetet e lehta. Këto tonalitete nuk krijohen duke përzier ngjyrat me të bardhën, por nga sasia e ujit që përdorim (fig. 2).

Është mirë që pasi të vendosim një shtresë, ta lëmë të thahet, pastaj të vendosim shtresën me ngjyrën tjetër, në mënyrë që nëpërmjet mbivendosjes dhe transparencës së ngjyrës të përftojmë edhe tonalitetin e duhur (fig. 3).




Ngjyrat mund të jenë me tubete ose në formë të ngrirë. Penelat që përdoren për teknikën e akuarelit duhet të jenë të butë dhe në formën e tyre karakteristike. Penelat duhet të lahen mirë mbas përdorimit.

Sipërfaqja më e mirë për të punuar me teknikën e akualetit është letra. Letra mund të jetë e lëmuar ose me rrudha, por e rëndësishme është që ajo të ketë cilësi të mirë, në mënyrë që uji të mos e prishë (fig. 4).

Letra mund të përdoret si e thatë, ashtu edhe e lagur. Në rastin e parë, letra e thith më shpejt ngjyrën dhe mbi të ndihet shenja e penelit.

Në rastin e dytë, ngjyra hapet në letër në mënyrë të njëtrajtshme.




4

VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet teknikës së akualetit



1. Qielet me re



2. Qielet me re dhe diell



3. Qielet në perëndim të diellit



4. Qielet në kohë stuhie

Qielli

- **Shiko** imazhet që tregojnë qiellin në katër momente të ndryshme.
- Me teknikën e akualetit, **realizo** edhe ti qiellin ose detin në momente të ndryshme, që tregojnë një gjendje të caktuar.



Peizazhi

- Shiko me vëmendje peizazhin (fig. b).
- Realizo edhe ti një peizazh me akualet.
- Në fillim, vizato me laps peizazhin tënd.
- Lage letrën me ujë nëpërmjet penelit.
- Përzgjidh ngjyrën e dëshiruar për çdo pjesë të peizazhit dhe përhape me penel.
- Me penelin e ngopur me ujë dhe me ngjyrë, bëj detajet, siç mund të jenë pemët, shtëpitë etj.

Materialet

- Letër
- Akualet

Çmo dhe vlerëso

- Shpjego mënyrën e realizimit të krijimit tënd dhe diskuto mbi karakteristikat e teknikës së akualetit.

3.

MOZAIKU

Mozaiku është një imazh që formohet nga copëza të vogla guri ose xhami të ngjyrosura, që vendosen së bashku sipas një vizatimi të caktuar. Mozaiku vendoset në mure ose në dysheme (fig. 1, Mozaik romak).


Realizimi i teknikës së mozaikut fillon me përgatitjen e vizatimit mbi të cilin vendosen dhe fiksohen copëzat e vogla (fig. 2).



Mozaiku, një teknikë antike


Teknika e mozaikut përdorej në Mesopotami e më pas nga grekët dhe romakët, të cilët zbukuronin muret dhe dyshemetë e vilave të tyre. Gurët që përdornin ishin natyralë: mermer, alabastër, granit etj. (fig. 4, Mozaik i dyshemesë për vilat romake).

Teknika e mozaikut është përdorur shumë edhe në periudhën e Bizantit. Ndryshe nga romakët, bizantinët përdornin materialin e pastës së xhamit të ngjyrosur për copëzat e mozaikut (fig. 3).



VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet teknikës së mozaikut

Mozaiku mund të realizohet me materiale të ndryshme.





Mozaiku me letër

- Shiko mënyrën se si është realizuar peshku në këtë mozaik romak. Copëzat e mermerit mund të zëvendësohen me letrat me ngjyra (fig. a).
- Realizo edhe ti një peshk, një kafshë ose një objekt tjetër, duke ndjekur hapat si në figurën b.

Materialet

- Letër
- Letra me ngjyra
- Fletë e bardhë
- Gërshërë
- Ngjitës



Materialet

- Fasule me ngjyra
- Oriz
- Makarona
- Thjerrëza etj.
- Vinovil
- Letër
- Laps



Mozaiku me fara

- Mozaiku mund të realizohet me shumë materiale të tjera: me gurë të vegjël, me lëvozhgat e vezës etj. Në këtë rast, ngjitësi që duhet përdorur është vinovili.
- Në figurat e mësipërme, janë realizuar mozaikë me fara të ndryshme.
- Shiko me vëmendje shembujt dhe mënyrën e realizimit të tyre (fig. c, d).
- Realizo edhe ti mozaikë duke përdorur materiale të tilla.

Çmo dhe vlerëso

Shpjego materialet që zgjodhe për të realizuar mozaikun tënd dhe diskuto mbi karakteristikat e kësaj teknike.

SHTYPI

Me teknikën grafike të shtypit kuptojmë kalimin e një imazhi nga një sipërfaqe në një tjetër. Për ta bërë këtë, në fillim përgatitet imazhi fillestar mbi një sipërfaqe të caktuar. Ky imazh shërben si një model, të cilin e përsërisim nëpërmjet teknikës së shtypit. Këto modele mund të realizohen në sipërfaqe të sheshta, me relief dhe me gërryerje (ose gdhendje).

Të gjitha këto metoda na japin mundësinë e shumëfishimit të imazhit.

Materialet mbi të cilat mund të shtypim janë të ndryshme, si letra, kartoni, druri, muri, tekstilet etj. (fig. 1, 2).




VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet teknikave të shtypit

Monotipi

Monotipi është një teknikë shtypi me anë të të cilit mund të përftohet vetëm një kopje e imazhit të përgatitur.


Realizo dhe ti një monotip duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- Mbi materialin e lëmuar, vendos ngjyrën pa e holluar, duke ndjekur një vizatim (fig. a).
- Mbi sipërfaqen e pikturuar, ende të patharë, vendos me kujdes një fletë vizatimi.
- Pa e lëvizur letrën, përshkoje nga sipër gjithë sipërfaqen e saj me një rul ose me një lugë, në mënyrë që letra të ngopet me ngjyrën e modelit.
- Me shumë kujdes, ngrije letrën mbi të cilën është përcjellë imazhi (fig. b).
- Nëpërmjet përhapjes së ngjyrës, imazhi i përfutur krijon efekte të rastësishme (fig. c).



Materialet

- *Tempera ose akuarele me tubet*
- *Një sipërfaqe e lëmuar, plastike ose xhami (ose letër e lëmuar)*
- *Një rul prej gome*



Shtypi me relief

Shtypi me relief mund të realizohet nëpërmjet përdorimit të materialeve të ndryshme. Për të realizuar këtë teknikë, modeli mund të jetë i gatshëm (për shembull, një objekt me një teksturë të caktuar) ose mund të realizohet vetë. Mjafton të krijojmë relievin e dëshiruar mbi një sipërfaqe, duke ngjitur objekte ose duke e gdhendur atë.



Shtypi me patate

Modelet e krijuara me patate janë të thjeshta për t'u përdorur. Mund të krijohen motive dekorative sipas dëshirës, pasi është e lehtë ta gdhendësh pataten (fig. f, g).

- Ndaje pataten në dy pjesë. Në sipërfaqen e prerë, vizato motivin dhe pastaj prite.
- Përgatit ngjyrën, e cila duhet të jetë e plotë dhe vendose mbi sipërfaqen e motivit me një penel të sheshtë.
- Vendose pataten mbi letër ose pëlhurë duke e përsëritur veprimin sipas një ritmi.

Çmo dhe vlerëso

Diskuto mbi teknikat dhe materialet e shtypit. Shpjego cilën teknikë shtypi zgjedhe dhe mënyrën e realizimit të krijimit tënd.

Materialet

- Patate e madhe me formë të rregullt
- Prerëse me majë të lëvizshme
- Tempera, nëse do të shtypësh mbi letër
- Ngjyra për tekstile, nëse do të shtypësh mbi pëlhurë


FOTOGRAFIA



Fjala “fotografi” e ka prejardhjen nga greqishtja dhe do të thotë “shkrim nëpërmjet dritës”. Parimi i fotografisë bazohet në zbulimin se disa substanca kimike janë të ndjeshme ndaj dritës. Një material, që i përmban këto substanca, bëhet i ndjeshëm ndaj dritës dhe është në gjendje ta ruajë imazhin. Ky material është **filmi fotografik** (fig. 1).

Sot, falë zhvillimit teknologjik, aparatet digjitale përdoren gjerësisht dhe lehtësisht nga të gjithë.

Teknika fotografike kalon nëpër tri faza: shkrepja e aparatit (fig. 2), zhvillimi i filmit (fig. 3) dhe stampimi (fig. 4).



Elementi kryesor në realizimin e fotografisë është **fotografi**. Ai duhet të zotërojë njohuri artistike, aftësi për të përdorur aparatën dhe teknikat fotografike, si dhe aftësi për të mbledhur informacionin e duhur nga realiteti.

Shpesh, cilësia estetike e një fotografie lind nga fakti se fotografi ka mundur të kapë një situatë të papritur ose ka pritur çastin e duhur për të shkrepur aparatën (fig. 5).



Imazhet fotografike dokumentojnë historinë

Pa dyshim, fotografia është mënyra më e përhapur e komunikimit nëpërmjet imazhit. Edhe pse mund të mos ketë cilësi artistike, ajo ka një vlerë të madhe historike, dokumentuese dhe shkencore. Fotografitë e bëra sot, nesër do të jenë pjesë e historisë, ashtu siç janë pjesë e historisë fotografitë e bëra vite më parë.



Në fotografimin e Kel Marubit, paraqiten Shota dhe Azem Galica në vitin 1920 (fig. 6).

Ura e Vezirit e ndërtuar në shek. XVII, ishte pjesë e rrugës tregtare Shkodër-Prizren (fig. 7).

VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet fotografisë

Histori pushimesh me fotografi në një vend të bukur që quhet Vilun dhe që ndodhet në rrethin e Shkodrës.





Fig. 1. Viluni është fshat bregdetar në Velipojë.

Fig. 2. Për të shkuar në plazh, duhet të kalosh nëpër një urë druri.

Fig. 3. Varkat e peshkatarëve nisen çdo mëngjes për të peshkuar.

Fig. 4. Atje, ndodhet edhe një pyll i dendur me pisha.

Fig. 5. Lëkura e gjinkallës ka mbetur në trugun e pemës.

Fig. 6. Tri delet duken të kënaqura me barin e freskët.

Fig. 7. Derrkuci nuhat për të gjetur ushqim.

Fig. 8. Breshka po shijon një lule të verdhë.

Fig. 9. Perëndimi i diellit është i magjishëm.

Realizo edhe ti një histori me fotografi, që tregojnë momente të ndryshme nga jeta jote.

Çmo dhe vlerëso

Tregoju shokëve dhe shoqeve të klasës historinë tënde me fotografi dhe rëndësinë e asaj historie për ty.

6.

DIZAJNI GRAFIK

Dizajni është një profesion ku përfshihen shumë veprimtari krijuese. E përbashkëta e këtyre veprimtarive krijuese është pikërisht aftësia për të ndërtuar një **projekt artistik**. Me projekt artistik kuptojmë zgjidhjen e një problemi në mënyrë krijuese.



Dizajni grafik ka lidhje me projektimin dhe realizimin e imazheve që komunikojnë ide. Detyrat e një dizajneri grafik janë projektimi dhe realizimi artistik. Ato përfshijnë faqosjen e një libri, të një reviste apo të një gazete; realizimin e paketimit dhe të reklamës së produkteve të ndryshme ushqimore dhe industriale, në mënyrë që të na japë të dhëna mbi përmbajtjen e këtyre produkteve; realizimin e ftesave, kartolinave, të ilustrimeve të librave, të kopertinës, duke përdorur imazhe dhe lloje të ndryshme shkrimi. Edhe piktori i filmit vizatimor është një dizajner grafik (fig. 1).

Puna përgatitore për mbledhjen e informacionit

Siç thamë më sipër, një nga detyrat e dizajnerit grafik është edhe ajo e realizimit të ftesave, të posterave ose edhe projektimi i një feste nga ana figurative. Festat në përgjithësi kanë karakteristikat e tyre.

Festa e Vitit të Ri ka simbolin e pemës e të zbulurimeve të ndryshme (fig. 2), festa e pavarësisë ka simbolin e flamurit dhe ngjyrat e tij, festa e nënës na kujton dashurinë e pafundme që ajo na dhuron (fig. 3).





Është bukur që t'i krijojmë vetë ftesat e ditëlindjes për shokët dhe shoqet.

Ditëlindja është një festë që çdo fëmijë e pret me shumë dëshirë. Pjesë e rëndësishme e festës së ditëlindjes është edhe ambienti festiv që krijojmë. Është bukur që këtë ambient ta krijoni ju vetë, sipas dëshirës (fig. 4, 5, 6).

VEPRIMTARI: Projektojmë dhe realizojmë ftesën e ditëlindjes

Projektimi

- Është e rëndësishme ta kuptojmë ftesën si një mjet komunikimi.
- Ftesa komunikon të dhëna mbi festën e ditëlindjes.
- Për këtë, është mirë të gjesh ose të krijosh një temë ose një simbol festiv (një personazh të parapëlqyer (fig. b), një kafshë simpatike (fig. c), një simbol që ka lidhje me vendin dhe veprimtaritë që do të zhvillohen (fig. d).
- Në bazë të simbolit të gjetur, është mirë të mendosh për formën, ngjyrat e zarfit dhe të ftesës.
- Gjithashtu, ftesa ka pjesën e shkrimit, e cila përmban të dhëna për vendin dhe datën ku do të zhvillohet festa. Kjo pjesë kërkon hapësirën e saj në ftesë (fig. a, d).



Realizimi

- Duke parë shembujt e ndryshëm, mund të krijosh një ftesë për një festë të caktuar dhe të përdorësh materiale e teknika të larmishme.

Çmo dhe vlerëso

Shpjego idenë e ftesës tënde dhe teknikën me të cilën e ke realizuar.

SKULPTURA



Skulptura është një formë tredimensionale e artit dhe mund të shihet nga të gjitha anët. Skulptor quhet artisti që realizon figura tredimensionale, që do të thotë: objekte që zhvillohen në gjatësi, gjerësi dhe thellësi. Materialet e skulpturës janë të shumta, si: argjila, dylli, allçia, guri, mermeri, bronzi, druri etj. Edhe mjetet që përdor skulptori janë të shumta (fig. 1).

Sipas karakteristikave të vëllimit, skulptura paraqitet në formë relievi dhe e rrumbullakët.



Te **relievi**, figurat ndërtohen mbi një sipërfaqe të sheshtë (reliev egjiptian).



Skulpturë e rrumbullakët është ajo që e shohim nga të gjitha anët ("Dhia", Pikaso).

Teknikat e skulpturës ndahen në dy grupe të mëdha: *modelimi* (fig. 4) dhe *gdhendja* (fig. 5).



Modelim do të thotë t'i japësh formën e dëshiruar materialit. Modelohen materiale, si: argjila, plastelina, allçia, letra e lagur. Gjatë modelimit, shtohet ose hiqet materiali me të cilin punohet.



Gdhendje do të thotë të heqësh material nga një bllok guri, druri apo mermeri me daltë dhe me çekiç. Gdhendja mund të realizohet edhe mbi materiale, si: allçia, dylli, sapuni etj.

VEPRIMTARI: Shprehem nëpërmjet modelimit



Tekstura dhe relievi

Relievi fillon që nga gjurmët e lehta që bëhen mbi një sipërfaqe, qoftë me gishta, qoftë me mjete të tjera.

Realizo edhe ti një reliev duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- Krijo një sipërfaqe të sheshtë me plastelinë (fig. a).
- Mbi këtë sipërfaqe dhe me mjetet që ke krijo tekstura të larmishme, duke ndjekur kombinime dhe ritme të ndryshme sipas fantazisë tënde (fig. b, c).

Materialet

- *Plastelina që ngrin "Das" ose brumi me kripë.*
- *Cdo mjet që mund të lërë gjurmë mbi materialin e butë të plastelinës.*



Modelimi i vazos

Modelimi i vazove është një teknikë antike. Përveç funksionit praktik, ato kanë edhe funksion dekorativ. Këto funksione e kanë shoqëruar gjithmonë artin e poçerisë.

Realizo dhe ti një vazo të thjeshtë dhe të bukur, duke ndjekur këta hapa:

- Përgatit një model letre, bazën dhe sipërfaqen anësore, në përmasat e dëshiruara dhe në varësi të materialit të plastelinës.
- Plastelinën përhape mbi një sipërfaqe duke përdorur një shishe ose një rul brumi.
- Prit plastelinën sipas modelit të letrës që ke bërë për bazën dhe për anët (fig. d, e).
- Bashkoji të gjitha pjesët, duke i ngjitur mirë me njëra-tjetrën (fig. f).
- Vazoja mund të dekorohet në mënyra të ndryshme (fig. g).

Materialet

- *Një fletë vizatimi*
- *Argjilë ose Das*
- *Gërshërë*
- *Thikë*

Çmo dhe vlerëso

Diskuto mbi mënyrën e realizimit të detyrës që zgjodhe (relievin apo vazon).

2.

KONSTRUKSIONI NË ARKITEKTURË


Çdo ndërtesë, e vjetër apo e re, përbëhet nga disa **elemente arkitektonike**, pa të cilat nuk do të rrinte dot në këmbë, që janë: **shtyllat mbajtëse, muret mbajtëse, trarët, harqet, dyshemeja dhe tavanet**. Janë pikërisht këto elemente që përbëjnë edhe strukturën e ndërtesave.

Nuk ka ndërtesa pa strukturë, edhe pse shpesh ato nuk janë të dukshme nga jashtë. Për realizimin e një konstruksioni, është shumë e rëndësishme që pjesët përbërëse të tij të jenë të qëndrueshme dhe në ekuilibër.

Ndërtesat përbëhen edhe nga elemente estetike dhe funksionale, të cilat, edhe nëse nuk janë të pranishme, zëvendësohen me elemente të tjera, që nuk e prishin qëndrueshmërinë dhe ekuilibrin e ndërtesës. Të tilla janë disa mure të jashtme dhe të brendshme ose pjesë dekorative.

Materialet që përdoren për ndërtimet janë: balta, druri, guri, hekuri, xhami, betoni, pra, materiale të forta dhe të qëndrueshme.


*Shtëpi prej druri (fig. 1).
Strukturë prej guri (fig. 2).
Kulla Eifel, Paris
një strukturë prej metali
(fig. 3).*



VEPRIMTARI: Ndërtimi i një kulle prej letre



Shiko konstruksionet e kullave që janë sjellë si shembuj: ilustrimin e kullës së Babelit dhe lartësimin e saj drejt qiellit (fig. 4); kullën veneciane të Durrësit në formë cilindri, e cila është e ndërtuar me gurë të madhësive të ndryshme (fig. 5); kullën e shek. XIX në Pejë, e cila ka formë katërkëndëshe (fig. 6).



Realizo edhe ti një kullë duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- Vizato mbi një fletë kartoni, gjashtë shirita vertikalë (nga 6 cm) dhe gjashtë shirita horizontalë (nga 4 cm) (fig. a).
- Priti shiritat sipas vijës horizontale dhe në fund të çdo shirit lër një zgjatim prej 1 cm (fig. b).
- Në të dyja anët e çdo drejtkëndëshi, bëj nga një prerje 0,5 cm në largësi 1,5 cm nga çdo brinjë e tij (fig. c).
- Palose çdo shirit në brinjën anësore të drejtkëndëshit, ngjite në pjesën e zgjatimit, në mënyrë që të krijojnë një unazë gjashtëkëndore për çdo shirit (fig. b).
- Vendosi njëra mbi tjetrën unazat e formuara, duke bashkuar pjesët e çara aty ku korrespondojnë me njëra-tjetrën (fig. d).
- Duke u bazuar në hapat e mësipërm, mund të krijosh modele të ndryshme kullash.

Çmo dhe vlerëso

Diskuto mbi modelin e kullës që krijove dhe mënyrën e realizimit.

Materialet

- Letër kartoni (ose përdor dy kartonë me ngjyra të ndryshme)
- Vizore
- Gërshërë
- Ngjitës



VERIFIKO NJOHURITË MBI TEKNIKAT ARTISTIKE

Përgjigju pyetjeve:

Shko në faqen përkatëse
për të vërtetuar përgjigjen:

▶ 1. Nga cili material formohet maja e lapsit?	54
☐ a. <i>Pluhur grafiti dhe argjile</i> ☐ b. <i>Druri</i> ☐ c. <i>Karboni</i>	
▶ 2. Për të modeluar, përdoren materiale të tilla si:	66
☐ a. <i>Mermeri</i> ☐ b. <i>Argjila</i> ☐ c. <i>Druri</i>	
▶ 3. Me se është e lidhur trashësia e vijës së lapsit mbi letër?	54

▶ 4. Çfarë materialesh mund të përdorim për mozaikun?	58

▶ 5. Sa dhe cilat janë fazat e teknikës së fotografimit?	62

▶ 6. Përse teknikën e akvarelit e quajmë një teknikë transparente?	56

▶ 7. Cilët janë elementet arkitektonike që përbëjnë strukturën e një ndërtese?	68

▶ 8. Cili është elementi kryesor në realizimin e një fotografie cilësore artistike?	62

▶ 9. Shpjego çfarë kupton me projekt artistik.	64



RELACIONI ART-SHOQËRI

Kjo tematikë i kushtohet historisë së artit dhe komunikimit nëpërmjet trajtimit të ngjarjeve artistike që nga parahistoria, duke vazhduar me artin në Mesopotami, atë egjiptian, grek, romak, me artin e qyteteve antike në Shqipëri e Kosovë, dhe me artin islam.

Qëllimi i saj është të trajtojë karakteristikat historike dhe shprehjet e tyre artistike. Gjatë këtyre mësimëve, do të dalë në pah lidhja midis gjuhës artistike, teknikave, materialeve të përdorura dhe veprave të artit të secilës periudhë. Do të shohim se imazhet e para në historinë e njerëzimit janë krijuar nga gjahtarët në epokën e gurit. Do të shohim lulëzimin e qytetërimit në Mesopotami dhe në Egjipt, krijimtarinë e jashtëzakonshme të qytetërimit grek dhe të qytetërimit romak.

Qytetërimin antik në Shqipëri dhe Kosovë, do ta shohim si pjesë të kulturës ilire, kurse ndikimet e dy kulturave greke dhe romake, si pjesë të rëndësishme të zhvillimit të tyre. Do të shohim edhe gjuhën e veçantë artistike të artit islam dhe ndikimin e tij në trojet shqiptare.

Në mësimin e fundit, do të vlerësojmë rolin e arkeologut, të restauruesit dhe të muzeut në zbulimin dhe ruajtjen e këtyre vlerave të trashëgimisë kulturore.

Mësimet 1-9

Njohuritë

- **Arti në parahistori** (periudha historike, shprehjet artistike, teknikat artistike, domethënia e imazheve, veglat e punës, arkitektura)
- **Arti i Mesopotamisë**
- **Arti egjiptian** (periudha historike, arkitektura madhështore e piramidave, skulptura, piktura)
- **Art antik grek** (periudha historike, arkitektura, skulptura, qeramika)
- **Art romak** (arkitektura, organizimi i qytetit, skulptura, piktura, mozaiku)
- **Qytetet antike në Shqipëri dhe Kosovë** (monumentet e rëndësishme, skulptura, mozaiku)
- **Arti islam** (qyteti dhe arkitektura, gjuha dekorative, arti islam në trojet shqiptare)
- **Arkeologjia, restaurimi dhe muzeu arkeologjik**

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/jja:

- **Shikon** veprat e artit të kulturave antike nga parahistoria deri në artin islam;
- **reflekt**on se si njerëzimi ndryshoi mënyrën e jetesës, duke kaluar nga jeta në shpellë e ndërtimi i kasolleve në formimin e qyteteve dhe në ndërtimin e arkitekturës monumentale;
- **zbulon**:
 - a. karakteristikat dhe domethënien e veprave të artit në kultura e periudha të ndryshme;
 - b. teknikat artistike të përdorura në këto kultura;
 - c. rolin edukues dhe komunikues të muzeut arkeologjik.

ARTI NË PARAHISTORI


Imazhet e para të historisë njerëzore janë krijuar nga gjuetarët në epokën e gurit. Veprimtaria figurative e popullsisë parahistorike u zhvillua për disa mijëvjeçarë, nga rreth 35 000 vjet p.e.s. deri në 10 000 vjet p.e.s. Në Europë, ajo u përhap nga Perëndimi në Lindje në qendra me interes të madh artistik, si në Francë (14 000 p.e.s. – 9 500 p.e.s.) dhe në Spanjë (14 000 p.e.s. – 10 000 p.e.s.)

Arti në epokën e gurit

Artistët në periudhën e paleolitit pikturonin me mjete të thjeshta. Një prej tyre ishte balta që gjendej në natyrë, e cila kishte ngjyra të ndryshme, si për shembull okër, të verdhë dhe të kuqe.

Këto piktura realizoheshin në thellësi të shpellave, ku nuk hynte drita. Njeriu i paleolitit pikturonte duke u mbështetur në kujtesën e tij pamore.

Pikturat paraqesin kafshë, të cilat njeriu parahistorik i gjuante për t'u ushqyer dhe ua përdorte lëkurën për t'u veshur. Kafshët janë kryesisht bizonë, drerë, kuaj etj. (fig. 1. Pikturë shpelle 16 000-vjeçare e gjetur në Francë).



Domethënia e imazheve

Arsyeja nuk ishte vetëm zbukuruese, por kishte një rëndësi të madhe jetike. Këto figura ishin të lidhura me ritet e gjuetisë, nga e cila varej mbijetesa e këtyre njerëzve.

Arti i veglave të gjahut

Njeriu i paleolitit krijonte edhe mjete për gjuetinë, disa prej të cilave ishin të gdhendura ose të realizuara me gërricje. Materialet më të përdorura ishin kockat e kafshëve, gurët, fildishi (fig. 2).

Skulptura

Dëshmi të prodhimit të skulpturës janë objektet në fildish, kocka e gurë që paraqesin figurën e një gruaje, që ndryshe quhej Venera. Këto janë figura shumë të vogla, me gjatësi deri në 10 - 11 cm, që i kushtohen figurës së nënës që lind dhe ushqen fëmijët (fig. 3).

Jeta në neolit

Si rezultat i zbutjes së klimës në tokë, rreth viteve 9 000 – 8 000 p.e.s., kushtet e jetesës së njerëzve ndryshuan. Në këtë periudhë u shfaqën format e para të bujqësisë, që favorizonin jetën nëpër kasolle dhe organizimin në fshatra.





Fig. 4. Figurë gjahtari parahistorik me veshjen e rindërtuar, bazuar në zbulimet arkeologjike.

Fshatrat në neolit shpesh ishin të krijuara në platforma mbi ujë, për t'u mbrojtur nga kafshët e egra. Ato quheshin palafite (Muzeu i palafiteve, në Ohër, fig. 5).




Teknika të reja

Krijimi në neolit është i lidhur me përdorimin e argjilës në prodhimin e enëve. Në fillim, enët bëheshin me baltën e argjilës së tharë e pastaj këto enë i piquin në furra me dru. Shpesh ato zbukuroheshin me vija të thjeshta gjeometrike në ngjyrë okre ose të kuqe (fig. 6).



Teknika e grafitit

Kjo teknikë realizohej nëpërmjet gërricjes me gurë të fortë dhe të mprehtë mbi disa materiale, si: balta, shkëmbi, guri, brirët, lëkura. Nëpër shpella janë gjetur piktura dhe figura të realizuara me gërricje (Grafiti i popullsisë së neolitit afër Bergamos, Itali, fig. 7.).





Fjalorth

► **paleolit:** periudha e gurit të vjetër

► **shpellë:** hapësira natyrore që formohen në brendësi të shkëmbinjve, ku strehoheshin njerëzit dhe kafshët

► **neolit:** periudha e gurit të ri



Periudha e neolitit në Kosovë


Datimi i neolitit në Kosovë, është relativisht i njëjtë për të gjithë territorin e Ballkanit, nga 6500-3500 p.e.s. Zhvillimi i kësaj periudhe në Kosovë është i ngjashëm me karakteristikat e zhvillimit të neolitit anekënd botës. Vendbanimet e periudhës neolitike në Kosovë janë të shumta, ndër to përmendim: vendbanimin në Vlashnje afër Prizrenit, të Runikut në komunën e Skenderajt, Varoshit në komunën e Ferizajt, i Zhitkocit në komunën e Zveçanit, i Barilevës, Tjerrtorja Prishtinë etj.

Figurina e “Hyjneshës në fron” e gjetur në rrethinat e Prishtinës, që i përket neolitit të vonë, është një nga artefaktet më të çmuara arkeologjike të Kosovës, të kësaj periudhe (fig. 8). Po ashtu edhe piktura shkëmbore e Vlashnjës, me figurën e spirales (fig. 9).

Çmo dhe vlerëso

- Çfarë ngjyrash kanë përdorur artistët e paleolitit në pikturat e shpellave?
- Çfarë figurash paraqesin pikturat e shpellave?
- Si realizohej teknika e grafitit?
- Cilat janë materialet që artistët gjuetarë përdornin për armët e gjahut?
- Ku dhe pse ndërtoheshin palafitet?
- Përmend disa nga vendbanimet e neolitit të zbuluara në Kosovë.

VEPRIMTARI: Mbrojmë kafshët



Materialet

- Letër
- Laps
- Lapsa me ngjyra ose flamastra


- A lejohet gjuetia për të gjitha kafshët e egra apo ndër to ka specie në mbrojtje? A di ndonjëren?
- A e di se çfarë do të thotë “specie në zhdukje”? Ç’rrezik i kanoset ekzistencës së tyre?
- A e njeh simbolin në fig. a? Për cilën kafshë bëhet fjalë? Përse është zgjedhur kjo kafshë si simbol?
- Në një letër vizatimi, krijo simbolin e një kafshe sipas mënyrës tënde. Zgjidh një kafshë në rrezik zhdukjeje. Imazhi duhet të jetë skematik, por me karakteristikat njohëse të kafshës (fig. b, c, d).

ARTI NË MESOPOTAMI

Rreth 3000 vjet p.e.s., jo shumë larg nga Mesdheu u zhvilluan dy qytetërime të mëdha: qytetërimi egjiptian dhe ai i Mesopotamisë. Karakteristika e tyre kryesore ishte terreni pjellor pranë lumenjve Tigër dhe Eufrat, gjë që solli zhvillimin e bujqësisë.

Lindja e qyteteve në Mesopotami

Midis viteve 3500 dhe 3200 p.e.s. në Mesopotami filluan të lindnin qytetet e para. Qytetet ishin të rrethuara me mure dhe hendekë, duke u bërë kështu rasti i parë në histori ku u krijua një ndarje midis mjedisit natyral dhe mjedisit qytetar të ndërtuar. Arkitektura e ndërtesave nuk ishte e njëjtë me ato të fshatrave të periudhave të mëparshme. Ndërtesat e pushtetit ndryshonin me ato të popullit të thjeshtë. Qendra e pushtetit në këtë periudhë ishte zigurati, tempulli i priftërinjve, përreth të cilit zhvillohej qyteti.



Argjila si material ndërtimi

Mungesa e materialeve të gurit dhe të drurit në Mesopotami, të njohura si materialet bazë të ndërtimit, bëri që materiali më i përdorur të ishte argjila. Ajo u përdor për poçerinë, për tabelat ku shkruheshin ngjarje apo legjenda dhe për ndërtesat monumentale. Për ndërtimet u përdorën tullat që në fillim piqeshin në diell e më pas në furrë me zjarr. Në këtë mënyrë ato bëheshin më të lehta dhe më të forta.

2

Arti figurativ në Mesopotami

Arti figurativ në Mesopotami nuk pati një zhvillim të njëjtë në qytetërimet e ndryshme që zunë rrënjë aty gjatë mijëvjeçarëve (përmendim: sumerët, akadët, babilonasit, asirët, medët, persianët). Megjithatë mund të dallojmë disa nga karakteristikat e përbashkëta të shprehjeve të ndryshme artistike:

- Veprat e artit ishin pothuajse gjithmonë të lidhura me ritet fetare dhe pushtetin.
- Në artet figurative dhe arkitekturë mbizotëronin njëtrajtshmëria dhe simetria.
- Në arkitekturë muret paraqiten solide me basorelieve me karakter dekorativ.
- Temat e veprave të artit ishin: sakrifica, luftërat, skenat e gjuetisë dhe ndeshjet mes kafshëve.

Fig. 2 Statuja e Gudesë, mbret i Lagashit, kryeqyteti i mbretërimit të dytë të sumerëve nga viti 2141 deri 2122 p.e.s., Muzeu i Luvrit, Paris

Arti sumer

Në qytetërimin sumer mori rëndësi skulptura e rumbullakët dhe relievi. Përdorimi i materialeve të tilla, si: alabastra, lapislazuli, ari, bakri, bëri të mundur realizimin e shumë veprave të pasura me ngjyra.

3

Fig. 3. Harkëtar persian, pjesë e zbukurimeve të pallatit të Darios në Susa, shek. VI-V p.e.s., Muzeu i Luvrit, Paris

4

Fig. 4. Reliev në rrënojat e pallatit persian Persepolis, gjysma e parë e shek. V p.e.s., Iran



5

Arti persian

Në artin persian mbizotërojnë basorelievet që dekoronin pallatet dhe shkallinat që paraqisnin ceremoni dhe homazhe për mbretin. Në këto figura, të vendosura në një ritëm të rregullt, të bie në sy palëvizshmëria dhe njëtrajtshmëria. I njohur për madhështinë e tij, është edhe pallati i mbretit persian Dario në Persepoli. Pallatet zbukuroheshin me dekoracione të pasura dhe me skulptura (fig. 3-4).

Forma e parë e shkrimit

Sumerët zhvilluan formën e parë të shkrimit (fig. 5). Me rritjen e qyteteve, njerëzit kishin nevojë për të mbajtur shënimet e tregtisë, të drejtat e pronësisë dhe të dhënat e qeverisë. Rreth 3300 vjet p.e.s. sumerët filluan të përdorin simbolet e figurave të shënuara në pllakat e baltës për të mbajtur të dhënat e tyre.



Fjalorth

- ▶ **alabastër** – lloj i veçantë shkëmbi gëlqeror, shpesh i bardhë ose i tejdukshëm, që përdoret për të gdhendur objekte ose skulptura dhe për ndërtim
- ▶ **lapislazul** – gur mineral në ngjyrë blu që përdoret si gur dekorativ ose si pigment

Çmo dhe vlerëso

- Cilët janë elementet përbërëse të një qyteti në Mesopotami?
- Cilat janë disa nga karakteristikat kryesore të artit figurativ në Mesopotami?
- Cilat janë disa nga materialet që përdoren në realizimin e skulpturave në Mesopotami?
- Cili ishte materiali më i përdorur për ndërtim në Mesopotami dhe si realizohej ai?

VEPRIMTARI: Stolitë

Artizanët luajtën një rol të rëndësishëm në kulturën e popujve të Mesopotamisë. Ata krijojnë objekte të përdorimit të përditshëm, si: enët, veshjet, bizhuteritë, shportat, anijet dhe armët. Ndër profesionet më të njohura përmendim poçarët, argjendarët, metalpunuesit, marangozët.

- Shiko stolinë femërore të kokës së punuar me shumë mjeshtëri dhe hijeshi nga argjendarët sumerë 2600-2500 vjet p.e.s. Gjethet janë punuar me ar dhe rruazat me lapislazuli.
- Krijo edhe ti një stoli (për dorën, kokën apo qafën) duke u mbështetur në motivin e gjethes. Realizojë në vizatim idenë dhe shpjego materialet me të cilat mund ta realizosh edhe vetë.




3.

ARTI EGJIPTIAN

Qytetërimi antik egjiptian ishte i lidhur ngushtë me lumin Nil, i cili favorizonte zhvillimin e bujqësisë, shkëmbimet tregtare dhe kulturore. Historia e Egjiptit ndahet në tri periudha të mëdha: Mbretëria e Vjetër (2850 - 2052 p.e.s), Mbretëria e Mesme (2052 - 1570 p.e.s.) dhe Mbretëria e Re (1570 - 715 p.e.s.). Periudha e Mbretërisë së Re ka qenë edhe periudha më e lulëzuar e Egjiptit antik, kryeqytet i të cilit ishte Teba.

Një shkallë drejt qiellit

Historia dhe kultura e Egjiptit antik ka tërhequr miliona vizitorë, sidomos për ndërtimet madhështore prej guri. Këto ndërtime monumentale janë piramidat, trashëgimi e njerëzimit.



Sfinksi i madh


Që prej rreth 4500 vjet më parë, Sfinksi bën rojë në piramidën e Kefrenit në Gizë dhe është skulptura më e madhe e rrumbullakët në gurë, që vjen nga kohët antike. Në mitologjinë egjiptiane, Sfinksi ishte një monument që ndërtohej pranë piramidave si simbol mbrojtës dhe përfaqësonte faraonin. Kjo skulpturë gjigante ka trupin e një luani me kokë njeriu (fig. 3).

Piramidat u krijuan si varre monumentale për njerëzit me pushtet. Në fillim, piramida shfaqet si një model i thjeshtë në formë paralelepipedit dhe quhej “mastaba” (fig. 1). Më pas, për të përfaqësuar idenë e ngritjes së faraonit drejt qiellit, këta paralelepipedë filluan të mbivendoseshin duke krijuar idenë e shkallëve. Në këtë mënyrë, filloi të merrte formën e përkryer piramidale.

Piramidat më të larta u ndërtuan gjatë Mbretërisë së Vjetër (dinastia IV) në kompleksin e Gizës dhe morën emrin e faraonëve përkatës: Keops, Kefren dhe Mikerino (fig. 2).

*Gjueti zogjsh, pikturë
varri, 1400 p.e.s.
(fig. 4)*

*Hathor dhe Seti,
pikturë varri, 1300
p.e.s. (fig. 5)*



Piktura dhe rregullat

Që nga kohët antike, në Egjipt piktura konsiderohej një art dytësor në krahasim me skulpturën. Piktura mori më shumë rëndësi gjatë Mbretërisë së Re. Ajo paraqet **tema fetare** ose të lidhura me **jetën e përditshme** të faraonit ose të njerëzve me pushtet.

Figura e njeriut, si në pikturë, ashtu edhe në skulpturë, paraqitej nëpërmjet një rregulli të quajtur **kanuni i përmasave**. Pikturat realizoheshin në mur dhe në papirus. Letra e papirusit përdorej për të pikturuar dhe për të shkruar.

Skulptura egjiptiane

Ashtu si në pikturë, edhe në skulpturën egjiptiane figurat njerëzore duhej të paraqiteshin sipas rregullave tradicionale ose sipas kanunit.

*Skulpturat prej druri,
alabastri ose guri
gëlqeror pikturoheshin
(fig. 6. Shkruesi).
Vetëm skulpturat
me granit nuk
ngjyroseshin.*

*Portretet në skulpturë
duhej të shprehnin
rëndësinë dhe
karakterin e shenjtë
të personave që
paraqisnin (fig. 7.
Nefertiti).*



Në Mbretërinë e Re, statujat filluan të bëheshin gjithnjë e më të mëdha deri në atë masë sa u bënë pjesë e arkitekturës.



Çmo dhe vlerëso

- Cilat ishin temat e pikturës egjiptiane në Mbretërinë e Re?
- Si paraqitej figura e njeriut në pikturat egjiptiane?
- Cili ishte funksioni i piramidave?
- Si quhej forma e parë e piramidës?
- Me çfarë materiale bëheshin skulpturat?

VEPRIMTARI: Shpendët

Materialet

- Letër
- Laps
- Lapsa me ngjyra

Rosat


- Në pikturat egjiptiane me temë nga jeta e përditshme, paraqiten shpesh shpendë.
- Shiko me vëmendje se sa natyrale është mënyra e paraqitjes së rosave në këtë fragment pikturë murale dhe sa bukur paraqiten detaje të tilla, si puplat apo teksturën e këmbëve.
- Provo të riprodhosh edhe ti në fletën tënde të vizatimit figurat e rosave.



Këtë e tregon fare mirë kompleksi monumental Abu Simbel (fig. 8).

Tempulli është i gdhendur në shkëmb dhe në hyrje të tij janë gdhendur katër figura gjigante të faraonit, prej tridhjetë metrash.

Fjalorth



► **kanuni egjiptian i përmasave** - Për të paraqitur figurën e njeriut, egjiptianët përdornin disa rregulla. Ata e ndanin figurën e njeriut në 18 katrorë, ku një katror është sa gishti i madh i dorës. Trupi i njeriut paraqitej në profil, por disa pjesë, si: shpatullat, busti dhe syri paraqiteshin përballë (fig. 9).

► **papirus** - një lloj letre e veçantë që përftohej nga trugu i pemës së papirusit me një teknikë të veçantë.

ARTI GREK

Arti antik grek lulëzoi në jug të Gadishullit Ballkanik në mijëvjeçarin e parë p.e.s. Në qytetet greke të quajtura polis, monumenti kryesor ishte tempulli, që konsiderohej si shtëpia e zotit mbrojtës të qytetit. (Tempulli i Athinasë, Partenoni, 447-432 p.e.s. fig. 1)

Përmasat e arkitekturës dhe të skulpturës greke nuk janë gjigante, siç ndodh në artin egjiptian. Ato janë më afër përmasave njerëzore, pasi perënditë ata i shihnin të ngjashme me njeriun.



Periudhat e artit grek

Sipas zhvillimit të kulturës, në artin grek dallohen katër periudha:

Periudha gjeometrike (shek. X - VIII p.e.s.), në të cilën bien në sy zbukurimet e vazove me figura abstrakte dhe gjeometrike.

Periudha arkaike (shek. VIII - VI p.e.s.), gjatë së cilës u krijuan modele të tempujve që qëndruan në kulturën artistike greke edhe në periudhat më pas.


Periudha klasike (shek. V - IV p.e.s.) është më e lulëzuara e artit grek.

Periudha helenistike (shek. IV - I p.e.s.) gjatë së cilës arti orientohet drejt një kërkimi më realist.

Tempulli grek

Tempulli u bë ndërtesa më përfaqësuese e identitetit kulturor dhe artistik grek, pasi ishte rezultat i zbatimit të rregullave të sakta për të arritur harmoninë midis pjesëve të tij. Tempujt janë të llojeve të ndryshme, në varësi të madhësisë dhe të vendit ku janë ndërtuar.

Rregullat arkitektonike ose stilet identifikohen me tri lloje kolonash, që kanë karakteristika specifike.





Teatri grek

Grekët u kushtonin rëndësi të madhe ndërtesave për shfaqje. Teatrot grekë ndërtoheshin në harmoni me pjerrësinë e terrenit (fig. 2). Teatri grek ishte në formë gjysmërrethi dhe përbëhej nga **shkallët ku uleshin spektatorët**. Tjetër pjesë e rëndësishme e teatrit ishte edhe **orkestra**, një hapësirë gjysmërrethore me diametër rreth 20 metra, ku rrinte kori. Pjesa tjetër ishte **skena**, e cila ishte një ndërtesë që të kujtonte ndërtesat ose tempujt dhe që shërbente si skenografi.

Stili **dorik**, në të cilin kapiteli është shumë i thjeshtë (fig. a).

Stili **jonik**, ku duken qartë format spirale te kapiteli (fig. b).

Stili **korintik**, ku bien në sy gjethet e gdhendura në kapitel, të frymëzuara nga një bimë (fig. c).



Skulptura greke

Skulptorët grekë përdornin shumë **gurin gëlqeror** dhe **mermerin**, pasi Greqia ishte e pasur me këto materiale. Ata përdornin edhe metalin për skulpturat e tyre. Grekët i ngjyrosnin skulpturat që të binin sa më shumë në sy, gjithashtu përdornin edhe arin dhe fildishin.

Funksioni i parë i skulpturës ishte **fetar**. Për këtë arsye, skulpturat vendoseshin në pjesë të ndryshme të tempullit. Ato paraqisnin **perënditë** dhe **fragmente nga mitologjia**, pjesë e së cilës ishin heronjtë dhe marrëdhëniet midis perëndive dhe njerëzve.


Një moment i rëndësishëm ishte edhe pasqyrimi i Olimpiadës nëpërmjet skulpturave të atletëve fitues që merrnin pjesë në të. Shumë rrallë skulptorët merreshin me temat nga jeta e përditshme.

Skulpturë e periudhës arkaike (fig. 3) Hedhësi i diskut, Mironi, periudha klasike (fig. 4) Niki i Samothrakës, periudha helenistike (fig. 5)

Vazot e pikturuara

Në Greqinë antike, si në të gjitha qytetërimet e tjera të lashta, lulëzoi edhe arti i **qeramikës** (balta e pjekur). Vazot e qeramikës krijoheshin me forma të rregullta dhe zbukuroheshin. Pikturat e vazove janë shembujt e vetëm të pikturës greke, pasi pikturat murale nuk kanë arritur deri në ditët tona.

Në periudhën e parë vazot dekoroheshin me **figura gjeometrike** (fig. 6). Në periudhën arkaike, filloi të përdorej **figura e njeriut**.



Fjalorth

- ▶ **kor** - një grup njerëzish që qëndronin pas aktorëve dhe i shoqëronin veprimet e tyre me këngë e me valle.
- ▶ **olimpiadë** - festa dhe lojëra sportive që zhvilloheshin në Greqinë e lashtë, në periudhën helene, çdo katër vjet.

Në vazot greke bien në sy dy stile të pikturës së vazos, stili me **figurat e zeza** (fig. 7), të pikturuara mbi ngjyrën e kuqërremtë të argjilës së pjekur, dhe më pas **figurat e kuqe** (fig. 8) mbi sipërfaqen e pikturuar me të zezë. Tematika ishte nga momente funerale, heroike, mitologjike dhe nga lojërat olimpike.

Çmo dhe vlerëso

- Cili ishte monumenti kryesor i tempullit grek?
- Cilat janë stilet arkitektonike greke?
- Cili ishte vendi i përshtatshëm për të ndërtuar teatrin grek?
- Cilat janë materialet që artistët gjuetarë përdornin për armët e gjahut?
- Cili ishte funksioni i parë i skulpturës greke?

VEPRIMTARI: Vazo me motive



Materialet

- Letër
- Laps
- Lapsa me ngjyra

- Vazot greke janë shumë të larmishme si nga format, ashtu edhe nga motivet.
- Shiko format e vazove greke dhe motivet e larmishme gjeometrike në to (fig. a, b).
- Vizato një vazo në fletoren tënde, duke u frymëzuar nga format e vazove greke.
- Më pas përzgjidh një motiv gjeometrik, sipas vazove greke, dhe përhape sipas dëshirës në vazon që ke vizatuar. Përdor një ngjyrë për sfondin dhe një ngjyrë për motivet (fig. c).
- Në këtë mënyrë, mund të krijosh vazo me forma dhe motive të ndryshme.

ARTI ROMAK

Shprehja artistike e Romës antike është e lidhur ngushtë me vetë zhvillimet e qytetit të Romës, që nga periudha republikane (510 p.e.s. – 30 p.e.s.) deri tek ajo perandorake, ku romakët e kishin zgjeruar shumë territorin e tyre (30 p.e.s. – 476 e.s.) Romakët u bazuan në përvojën e ndërtuesve etruskë dhe, pasi pushtuan Greqinë, filluan të imitonin artin dhe rregullat arkitektonike greke.

Arkitektura

Në arkitekturë, romakët zhvilluan më tej elementin e harkut, i cili mbështetej mbi dy kolona. Ai ishte i qëndrueshëm dhe i bukur.



Harkun romak e gjejmë në ndërtime të tilla, si: Harku i triumfit i Titit, Romë (fig. 1); ura e Gardit në Francë, pjesë e ujësjellësit romak, që formohet nga një varg harqesh të vendosura njëri pas tjetrit (fig. 2), si edhe nëpër amfiteatro. Kolonat e tipit grek ndërthureshin në muret e ndërtesave të mëdha.

E veçantë është edhe arkitektura e Koloseumit në Romë, një amfiteatër ku zhvilloheshin luftimet me gladiatorë dhe lojëra të ndryshme (fig. 3).

Organizimi i qytetit


Romakët ndërtuan me qindra qytete dhe rrugë, me anë të të cilave lidhën midis tyre qendrat e banimit. Ata kishin aftësi të organizonin territorin, qoftë për t'iu përgjigjur nevojave të njerëzve, qoftë për të mbajtur nën kontroll popujt e pushtuar. Në qytetet e mëdha, romakët ndërtuan banja publike, qendra sportive, biblioteka etj. Ndërtesat romake kishin forma të ndryshme, rrethore, gjysmërrethore, kishin lulishte e sallone të mëdha të mbuluara. Shtëpitë e qytetarëve të thjeshtë ishin ndërtesa me disa kate me hapësira të vogla (fig. 4).





Shtëpia “domus”

Domusi ishte shtëpia e romakëve të pasur. Shembuj të kësaj shtëpie janë ruajtur në Pompei dhe Erkolano, dy qytete romake afër Napolit, të cilat u mbuluan nga shpërthimet e vullkanit Vezuv në vitin 73 p.e.s. Në to, janë ruajtur statujat që zbukuronin shtëpinë, mozaikët dhe pikturat murale. Dhomat e domusit ishin të ndërtuara rreth kopshtit, i cili ndodhej në mes të kompleksit (fig. 5).



Skulptura romake

Skulptura përfaqëson më së miri karakteristikat e artit romak. Artisti skulptor në veprat e tij tregon fitoret nëpër beteja dhe madhështinë e gjeneralëve romakë (fig. 6, *Statuja e perandorit August*). Këto skulptura vendoseshin nëpër vendet publike të qytetit. Skulptorët romakë studiuin dhe u frymëzuan nga arti grek. **Portreti** mori një rëndësi të veçantë në artin romak. Skulptorët donin të arrinin **ngjashmërinë** me personazhin dhe të paraqisnin **karakteristikat e veçanta** në mënyrë sa më **realiste** (fig. 7, *Portret gruaje*). Këtë lloj realizmi e shohim të shprehur edhe në portretet në pikturë (fig. 8, *Portret gruaje*).

Piktura murale

Forma e pikturës romake, që ka ardhur deri në ditët tona, është piktura murale. Shembujt e pikturës murale i gjejmë në Pompei dhe në Erkolano, qytete romake afër Napolit, të cilat u mbuluan nga shpërthimet e vullkanit Vezuv në vitin 73 p.e.s.

Piktura përdorej edhe për të **imituar mermerin** që vishte muret për efekt dekorimi.

Këto piktura paraqesin skena nga **mitologjia** (fig. 9), **ndërtesa** (fig. 10), skena të **ambienteve të brendshme** (fig. 11).

Mozaiku

Shtëpitë romake shpesh zbukuroheshin me mozaikë, por kjo teknikë përdorej më shumë nëpër vendet dhe në ndërtesat publike. Mozaiku përdorej për dekoret e mureve dhe të dyshemeve.

Për mozaikët e dyshemeve, përdorshin kryesisht **gurë natyrorë**, ndërsa për ata të mureve, **copa xhami**. Romakët përdornin disa teknika, si: atë me **gurë të mëdhenj** dhe atë me **gurë të vegjël** (fig. 12. Mozaik romak i gjetur në një vilë në Pompei).



Çmo dhe vlerëso

- Cili ishte elementi që u zhvillua më shumë në arkitekturën romake?
- Si ishte i organizuar qyteti romak?
- Shtëpia e kujt klase shoqërore ishte domusi?
- Çfarë lloj guri përdornin romakët për mozaikët e dyshemesë dhe mozaikët e murit?
- Cilat janë karakteristikat e portretit në skulpturën romake?



Fjalorth

► **qytetërimi etrusk** u zhvillua në shek. IX – VIII p.e.s. në zonën qendrore të Italisë së sotme.

VEPRIMTARI: Mozaik



- Shiko me kujdes bordurat dekorative të mozaikëve romakë që vendoseshin në dysheme.
- Realizo edhe ti një mozaik të thjeshtë si projekt për dysheme.
- Duke u mbështetur te dekoret e mozaikut romak, vizato idenë e më pas realizoje me teknikën e mozaikut me letër (shiko teknikën e mozaikut në f. 55).
- Efektin e mozaikut mund ta realizosh edhe duke ngjyrosur kuadratet e vizatuara me lapsa ose duke përdorur flamastera me majë katrore.

6.

QYTETET ANTIKE NË KOSOVË DHE SHQIPËRI

Qytetet bregdetare Butrinti, Apolonia, Durrësi, edhe pse i përkasin kulturës ilire, në shekullin VII p.e.s. u ndikuan nga kultura greke dhe më pas nga ajo romake, si rrjedhojë e kolonizimit të tyre.



Arkitektura

Në Butrint ruhen gjurmët e arkitekturës së çdo periudhe të zhvillimit të qytetit. Arkitektura më e hershme e zbuluar në këtë qytet është muri rrethues i qytetit me gurë kuadratikë të mëdhenj, që i përket stilit arkaik. Muri kishte dy porta, njëra është Porta Skea, 5 metra e lartë, tjetra është Porta e Luanit, e cila ka të gdhendur sipër, te trari prej guri, një luan që shqyen një kokë kau (fig. 1).

Ndër dëshmitë e arkitekturës më interesante të **Butrintit**, do të përmendim **teatrin**, të ngritur në shekullin III p.e.s., i cili përbëhet nga tri pjesë, njësoj si teatrot grekë. Teatri formohet nga 19 radhë **shkallësh** në formë gjysmëharku me blloqe guri të bardhë për spektatorët. Pjesët e quajtura **orquestra** dhe **skena** janë ndërtuar me gurë dhe me harqe (fig. 2). Skena u rindërtua në periudhën romake. Këtë e vërtetojnë harqet dhe përdorimi i tullës (si karakteristika të arkitekturës romake).




Monumenti më i rëndësishëm në qytetin e **Apolonisë** është **Monumenti i Agonotetëve** (*Selia e Këshillit të qytetit*, fig. 3), i ngritur në periudhën romake në stilin korintik. Kjo është një ndërtesë që të kujton traditën e ndërtimeve greke me kolonat dhe frontonin në formë trekëndëshi.



Për qytetin antik të **Durrësit**, monumenti më i njohur është **amfiteatri**, i ndërtuar në periudhën e pushtimit romak (fig. 4). Amfiteatri, ndryshe nga teatri, është në formë **rrethore ose elipsi** dhe përdorej për të parë ndeshjet e gladiatorëve. Aty spikasin kolonat prej graniti dhe pjesët e dysHEMEVE të shtruara me mozaik.

Skulptura

Skulptura ka qenë e lidhur ngushtë me arkitekturën dhe përdorej për zbukurimin e shesheve publike, të ndërtesave administrative dhe fetare, si në mjediset e jashtme, ashtu edhe ato të brendshme (fig. 6. *Skulptura të ekspozuara në muzeun arkeologjik të Apolonisë*). Ato paraqesin perëndi (fig. 5. *Statujë e perëndeshës së Apolonisë*), figura mitologjike (fig. 7. *Sfinksi, Muzeu Kombëtar Tiranë, shek. III p.e.s.*), figura atletësh, luftëtarësh, filozofësh. Edhe skulptura e këtyre qyteteve, u ndikua nga arti grek dhe romak.



Mozaiiku më i vjetër është gjetur në Durrës (shek. IV-III p.e.s.) dhe paraqet kokën e një vajze të realizuar me gurë të vegjël zalli, me tri ngjyra.

Mozaiiku

Mozaiikët e zhvilluar më shumë në periudhën e sundimit romak, janë ndërtuar në lidhje të ngushtë me arkitekturën. Mozaiku u përdor në shtrimin e dysHEMEVE të vilave, të godinave publike dhe të atyre të kultit. Motivet e përdorura janë gjeometrike, subjekte mitologjike, zoologjike dhe floreale.

Periudha romake në Kosovë

Në shekullin I e.s., pas pushtimit të plotë të Ilirisë, romakët vendosën sistemin e tyre administrativo - ushtarak edhe në Dardani, gjë e cila solli përhapjen e qytetërimit dhe të kulturës romake.



Municipium d.d. (Dardanorum)

Parku arkeologjik Municipium DD (Dardanorum), është i pozicionuar afër Mitrovicës. Gjurmët e arkitekturës të gjetura aty janë, forumi, horrea, bazilika urbana, pjesë të termave dhe detaje të disa objekteve shoqëruese si dhe nekropoli verior. Municipium DD ka ekzistuar fillimisht si vendbanim parahistorik e më pas është zhvilluar në një qytet të mirëfilltë antik romak në periudhën kohore prej pjesës së fundit të shek. I e deri në pjesën e parë të shek. IV të erës sonë (fig. 8, 9).



Municipium Ulpiana

Ulpiana e arriti formën e një qendre të urbanizuar disa dekada pas pushtimit të Dardanisë nga romakët, në shekujt III dhe IV të e.s. Në këtë periudhë ajo u kthye në një qendër të fortë politike, ekonomike dhe kulturore për një territor të gjerë në brendësi të Dardanisë.


Qyteti gjatë kësaj periudhe kohore gëzonte epitelin Municipum Ulpiana Splendissima (municipi i Ulpianës madhështore apo të shkëlqyeshme) dhe karakterizohej nga rrjetet e rrugëve të drejta, ujësjellësi, objektet e banimit e objektet publike dhe ishte një qendër urbane me rëndësi zejtare, tregtare e bujqësore (fig. 10).

Mozaiku

Mozaikët e periudhës së antikitetit të zbuluar në territorin e Kosovës konsiderohen mjaft të veçantë për vlerat artistike që paraqesin. Edhe këtu mozaikët janë të lidhur ngushtë me arkitekturën. Ndër mozaikët më të veçantë përmendim atë të Gllamnikut që njihet ndryshe si “Vendenis” (prej emrit të qytetit antik të Vendenis) (fig. 11). “Vendenis” është një mozaik dyshemeje i realizuar me gurë, me motive gjeometrike dhe në qendër të tij ka figurën e Orfeut. Në mozaikun e Nerodimes, të zbuluar në dyshemenë e një vile, bien në sy motivet gjeometrike dhe figura të ndryshme (floreale, zoologjike dhe mitologjike) (fig. 12).

Skulptura

Një nga gjetjet më të rëndësishme, të punimit të skulpturës, fare pranë Banjës së Klllokotit është busti i një zonje dardane në mermer (fig. 13). Një vepër arti që përfaqëson zhvillimin e krijimtarisë së lartë artistike të popullsisë vendase.



Fjalorth

► **park arkeologjik** - vendi ku ruhen dëshmitë e veprimtarive njerëzore në kohët e shkuara, që janë zbuluar nga arkeologët.

Çmo dhe vlerëso

- Cilat janë dy kulturat kryesore që ndikuan në zhvillimin e qyteteve antike në Shqipëri dhe Kosovë?
- Cilat janë monumentet më të rëndësishme në qytetet antike të Butrintit, të Apolonisë dhe të Durrësit?
- Cilat gjurmë arkitekture janë gjetur në Municipium d.d. dhe Municipium Ulpiana?
- Cilat janë motivet e mozaikëve?

VEPRIMTARI: Vizitë në parqe arkeologjike

Varret monumentale të Selcës, shek. III p.e.s.



Parku arkeologjik i Komanit



Teatri i Sofratikës i përket qytetit të Adrianopolit, shek. II e.s., rrethi i Gjirokastrës




Parku arkeologjik i Ulpianës

- Vizito qendrat arkeologjike dhe qendrat e banimit të antikitetit që ndodhen afër qytetit ose fshatit tënd.
- Shiko me kujdes objektet arkitektonike të mbetura, karakteristikat e tyre. Kujto njohuritë që ke marrë në mësimet mbi antikitetin dhe krahaso me ato që sheh aty.
- Ndiq me vëmendje tregimet e ciceronit dhe drejtoji pyetje për gjërat që nuk kupton.
- Fotografo monumentet më të rëndësishme dhe detaje që të tërheqin në qendrën arkeologjike.
- Diskuto me shokët dhe shoqet e klasës mbi karakteristikat e ndërtesave, të objekteve, si dhe për çfarë përdorëshin ato.

ARTI ISLAM

Në fillim të shek. VII e.s., arabët përfaqësonin një kombësi që identifikohet me vetë besimin islam. Në këtë periudhë ky popull fillon një proces zgjerimi. Në hapësirën kohore prej një shekulli, popullsia arabe, nga gadishulli arabik arrin perëndimin deri në Spanjë dhe lindjen deri në Indi, duke pushtuar kështu territore persiane dhe bizantine. Ky proces solli edhe përhapjen e fesë islame sipas udhëzimeve të shkruara në librin e shenjtë të Kuranit. Arti islam arriti maksimumin e shprehjes së tij në periudhën e mesjetës. Ky art trashëgoi pasurinë e botës antike dhe njëkohësisht bëri një bashkim të kulturave të ndryshme.



1

Qyteti dhe arkitektura islame


Qyteti islam ishte i rrethuar me mure, brenda të cilave xhamia dhe minarja e lartë binin në sy. Afër xhamisë ndodhej pallati/fortesë i mbretit dhe qendra tregtare e artizanale e qytetit. Xhamia përfaqësonte ndërtesën publike. Ajo ishte vendi i lutjeve, gjykata, vendi i pushtetit politik dhe i ligjvënies. Përreth këtyre ndërtesave dhe qendrës tregtare ndodheshin lagjet e banimit, të ndara për shtresat e ndryshme shoqërore.



2

Një gjuhë abstrakte dhe dekorative

Sipas mendimit islam, arti nuk duhet të imitojë natyrën, pasi do të ndryshonte veprën e krijuar nga Zoti. Arti islam, ndryshe nga ai i krishterë, nuk është figurativ. Në këtë mënyrë filloi të mbizotërojë prirja për të paraqitur imazhe të stilizuara dhe abstrakte, si për shembull, vizatimet dekorative dhe arabeskat. Zbukurimet paraqiten tri llojesh: floreale (bimore), gjeometrike dhe kaligrafike (që përdor shkrimin).



3

Hapësirë arkitektonike me motive figurash gjeometrike të realizuara me teknikën e mozaikut (ylli tetëcepësh)

Hapësirë arkitektonike e brendshme



Kupola e Xhamisë së Et'hem Beut në Tiranë e zbukuruar me arabeska dhe motive floreale

Arti islam në trojet shqiptare

Shtrirja e Perandorisë Osmane në Ballkan solli edhe zhvillimin e artit islam në trojet shqiptare.


Gjatë kohës së sundimit të Perandorisë Osmane iu kushtua rëndësi veçanërisht arkitekturës, si: ndërtimit të urave, të xhamive dhe të shtëpive. Ndër monumentet islame me vlera të veçanta kulturore dhe historike në trojet shqiptare mund të përmendim: Xhaminë e Et'hem Beut në Tiranë, Xhaminë e Madhe në Prishtinë, Xhaminë e Larmë në Tetovë, Xhaminë e Mustafa Pashës në Prizren, Xhaminë e Pashës (me hamam) në Ulqin etj.



Xhamia e Sulltan Mehmet Fatihut II (Njihet ndryshe si Xhamia e Madhe apo Xhamia e Mbretit), Prishtinë, daton në vitin 1461.

Xhamia e Madhe në Prishtinë

Kjo xhami është një nga monumentet më të rëndësishme të arkitekturës islame në Evropën Juglindore. Ajo shquhet për mënyrën e ndërtimit, përdorimin e gurëve të gdhendur ranorë, elementet dekorative. Kupola e saj, ka një zgjidhje mjaft të mirë arkitektonike për shkak të madhësisë së saj të konsiderueshme.



Çmo dhe vlerëso


- Cilat janë karakteristikat kryesore të qytetit islam?
- Cila ishte gjuha artistike që zhvilloi arti islam?
- Ku u pasqyruan më së shumti zhvillimet e artit islam në trojet shqiptare?
- Cilat janë disa nga ndërtesat e kultit më interesante nga ana arkitektonike?



Fjalorth

arabeska - është një formë dekorative artistike e përbërë nga modele lineare ritmike dhe gërshetimi i gjetheve, shpesh të kombinuara me elemente të tjera.

VEPRIMTARI



Kaligrafia islame është pa dyshim kontributi më original i islamit në artet figurative. Me një shenjë elegante dhe të përpunuar ajo sjell pjesë fetare e sidomos Kuranin dhe poezitë. Kaligrafia është një shfaqje e aftësive të të shkruarit.

- Shiko shembujt e kaligrafisë ose kërko shembuj të tjerë.
- Ushtrohu në riprodhimin e shenjave, shoqëro shkrimin me një motiv dekorativ nga arti islamik si në shembullin e dhënë.

ARKEOLOGJIA, RESTAURIMI DHE MUZEU



Arkeologjia

Shumë dëshmi të historisë antike, shpesh, gjenden të fshehura poshtë shtresave të tokës ose nën ndërtimet e reja.

Arkeologu është zbuluesi që sjell në dritë këto dëshmi materiale të kohës së shkuar, vlerëson cilësinë estetike dhe përcakton kohën së cilës i përket (fig. 1). Pas zbulimit, objektet bëhen pjesë e trashëgimisë kulturore të vendit.




Arkeologu përdor teknika studimi të **shkencës së arkeologjisë** për t'i nxjerrë në dritë dhe për t'i datuar këto objekte të gjetura. Kërkimet arkeologjike zhvillohen jo vetëm **në tokë** (fig. 2), por edhe **në det** (fig. 3). Në det ndodhen objektet që kanë rënë nga anijet antike ose objekte që u përketin zonave të përmblytura nga uji.

Restaurimi dhe ruajtja e objekteve

Çdo objekt i gjetur pas shumë shekujsh, në çastin e parë kur bie në kontakt me dritën mund të dëmtohet. Objekti, pasi pastrohet, duhet restauruar dhe duhet ruajtur në një ambient me temperaturë të përshtatshme. Me **restaurimin** e objekteve merren **restauruesit profesionistë**, të cilët duhet të njohin shumë teknika antike të punimit të objekteve (fig. 4).

Muzeu arkeologjik

Muzetë i marrin emrat sipas veprave të artit që ekspozojnë. Muzeu arkeologjik është vendi më i përshtatshëm për të ruajtur dhe për të ekspozuar veprat e antikitetit.



Me qëllim që të ruhen sa më mirë, këto objekte largohen nga vendi ku janë gjetur dhe ku kanë pasur një funksion dhe një lidhje të caktuar me ritet e mënyrën e jetesës, dhe ekspozohen në muze.

Nëse objektet në muze nuk do të kishin të dhëna, ato nuk do të mund të komunikojnë me vizitorët. Për të realizuar këtë komunikim, ndihmojnë studimet mbi epokën së cilës i përketin këto objekte.


Objektet e artit të ekspozuara në muze na njohin me traditat, me mënyrën e të jetuarit dhe të të menduarit të njeriut në atë periudhë.



Kur ekspozohen në muze, këto objekte duhet të kenë të dhëna të tilla, si: **periudhën** së cilës i përketin, **emrin** e objektit dhe **funksionin** e tyre.

(fig. 5. Stelë varri e Domicius Sarcianor (Rrobaqepësit), gur gëlqeror, shek. I. e.s.)

VEPRIMTARI: Vizitë në muzeun arkeologjik



Çdo muze arkeologjik zotëron një koleksion përkatës me vepra të tilla, si skulptura e stela varri; objekte, si vegla pune, bizhuteri, enë qeramike për përdorime të ndryshme, enë qelqi, monedha (fig. 6. Stendë me figurina qeramike; Fig. 7. Stendë me enë qeramike; Fig. 8. Sallë ekspozimi). Muzeu përbëhet nga sallat, ku në secilën prej tyre ekspozohen objekte të së njëjtës periudhë historike. Objektet nëpër salla paraqiten në stenda prej xhami ku vendosen kryesisht ato të të njëjtit lloj.



Gjatë vizitës në muze, ndiq këto rregulla:

- Ndiq radhën e vendosjes së sallave dhe të stendave nga e para tek e fundit.
- Shiko me vëmendje objektet e ekspozuara.
- Lexo të dhënat për çdo stendë dhe objekt për të kuptuar më shumë mbi të (fig. 9).
- Dëgjo me vëmendje ciceronin e muzeut, mbaj shënime dhe drejtoji pyetje për gjërat që nuk kupton.
- Në muze mbahet qetësi në mënyrë që të gjithë të marrin informacion.
- Objektet e ekspozuara nuk duhet të preken me dorë.

Çmo dhe vlerëso

- Diskuto në klasë me shokët e shoqet rreth koleksionit që patë në muze dhe objekteve që ju bënë më shumë përshtypje dhe pse.

ÇMUARJA DHE VLERËSIMI

Krahasojmë teatrin grek me amfiteatrin romak



Shiko imazhet



Tashmë je njohur me disa karakteristika të teatrit grek dhe të amfiteatrit romak. Për të bërë një krahasim më të detajuar kemi nevojë për të dhëna shtesë.

Teatri grek

Grekët shfrytëzonin terrenin e pjerrët natyral për të ndërtuar teatrot.

Teatrot grekë shërbenin për shfaqjet e komedisë e të tragjedisë, por edhe për festa me kostume.

Fjala “theatron” do të thotë, vendi nga ku mund të shohësh. Pjesë të ndryshme të ndërtesës ishin menduar si për të lejuar zhvillimin e plotë të shfaqjes dhe për shikueshmërinë e plotë, ashtu edhe për dëgjimin maksimal nga ana e publikut.

Teatri ndëртоhej në formë gjysmë rrethi dhe përbëhej nga tri pjesë:

Skena, një ndërtesë që bëhej prej druri e më pas prej guri. Ajo ishte vendi ku recitonin aktorët.

Orkestra, një hapësirë gjysmë rrethore ku rrinte kori, përbëhej prej disa personave që shoqëronin me komente ose me kërcime veprimet e “aktorëve”.

Vendi ku uleshin spektatorët kishte formë gjysmë rrethi dhe ndodhej në pjerrësinë e terrenit shkallë-shkallë. Në të mund të uleshin të gjithë përveç skllevërve.

Amfiteatri romak

Fjala amfiteatër vjen nga greqishtja (“amfi” që do të thotë rreth e qark dhe “theatron” do të thotë, vendi nga ku mund të shohësh).

Amfiteatri është një ndërtesë e hapur në formë elipsi që përdorej për shfaqjet e luftërave me gladiatorë apo argëtimet me gjuajtjen e kafshëve.

Amfiteatri romak përbëhej nga tri pjesë:

Vendi ku uleshin spektatorët, i cili formohej me radhë shkallësh. Ajo organizohej në tri hapësira horizontale që i përgjigjeshin tri klasave të ndryshme shoqërore.

Arena ku zhvilloheshin ndeshjet.

Vomitorium (për të nxjerrë përpara) janë hyrje të harkuara që shërbenin për të bërë shpërndarjen e shpejtë të turmave të njerëzve.

Mbasi të lexosh këto të dhëna, zgjidh karakteristikat e veçanta për secilën e më pas ato të përbashkëta, duke u mbështetur në këto pika:

Teatri grek (karakteristikat e veçanta)

- Forma
- Nga sa pjesë përbëhej
- Emërtimi i pjesëve dhe për çfarë shërbenin

Karakteristikat e përbashkëta

Amfiteatri romak (karakteristikat e veçanta)

- Forma
- Nga sa pjesë përbëhej
- Emërtimi i pjesëve dhe për çfarë shërbenin

Në këtë mënyrë mund të krahasosh skulpturën greke me atë romake, artin e Mesopotamisë me atë egjiptian etj.



VERIFIKO NJOHURITË MBI HISTORINË E ARTIT

Përgjigju pyetjeve:

*Shko në faqen përkatëse
për të vërtetuar përgjigjen:*



- ▶ 1. Çfarë materialesh përdorte njeriu i paleolitit për veglat e gjahut?

72-73



- ▶ 2. Vendos titullin dhe përshkruaj çfarë paraqet kjo figurë.

72-73



- ▶ 3. Çfarë ishte zigurati?

75-77



- ▶ 4. Si quhet ky monument dhe ku është i vendosur?

78-80



- ▶ 5. Cilës periudhë i përket kjo vazo?

81-83



- ▶ 6. Cilit stil arkitektonik i përket ky kapitel?

81-83



- ▶ 7. Çfarë paraqet kjo skulpturë?

87-90



- ▶ 8. Çfarë lloj veprimtarish zhvilloheshin në amfiteatrot romakë?

84-86



- ▶ 9. Çfarë janë arabeskat?

91-93



- ▶ 10. Si quhet profesioni që merret me nxjerrjen në dritë të dëshmive materiale të kohës së shkuar?

94-95

Fjalor

iluzion optik - perceptim i gabuar i një imazhi nga shqisa e të parit.

shenja - vizë ose figurë për të treguar diçka përmes në artin figurativ.

forma dydimensionale - një vijë e mbyllur, e cila rrethon një sipërfaqe të sheshtë, që ka gjerësi dhe gjatësi.

tekstura - karakteristikë e përbërjes lëndore dhe e sipërfaqes së objekteve.

vëllimi - veçori e formës tredimensionale, që bëhet e dukshme nëpërmjet dritës dhe hijes.

hija e objektit - forma e një objekti që shfaqet në zonën e pandriçuar dhe që thekson konturin e tij.

hije e mbartur - hija që objekti lëshon mbi sipërfaqen ku është mbështetur.

treguesit hapësinorë - metoda që na ndihmojnë për të paraqitur thellësinë hapësinore mbi një sipërfaqe dydimensionale, siç janë piktura dhe vizatimi.

parimet e kompozimit - mënyra e organizimit të elementeve të artit.

baraspesha simetrike - kur elementet që përbëjnë një objekt ose kompozim, janë të njëjta në të dyja anët e aksit (boshtit) të simetrisë.

simetria rrethore - kur të gjitha anët e objektit janë të barabarta dhe i referohen pikës së simetrisë që përkon edhe me qendrën e rrethit.

ritmi në artin dekorativ - përsëritja e motivit në mënyrë të rregullt ose të ndërlikuar.

harmonia - kur të gjitha elementet e artit lidhen dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Përsëritja e tyre me një ritëm të caktuar, është një mënyrë e mirë për të arritur harmoninë në një vepër arti.

kontrasti - dallim i madh midis dy objekteve ose fenomeneve.

proporcioni në kompozim - marrëdhënia midis dy ose më shumë objekteve.

REFERENCAT

- Kurrikula lëndore/programi mësimor: *Art figurativ 6*; Republika e Kosovës, gusht, 2018
- Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës, Fusha e Kurrikulës Artet; Instituti Pedagogjik i Kosovës; Republika e Kosovës; Mars 2014
- Angela Wenzel; *13 Art Techniques Children Shoud Know*; PRESRTTEL, Munih-London-New York, 2013
- *Guidë arkeologjike e Kosovës*; Milit Berisha; Botues: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Instituti Arkeologjik i Kosovës, Prishtinë 2012
- Edmund Burke Feldman; *Varieties of visual experience, Art as Image and Idea*; New York, second edition
- Rudolf Arnheim; *Arte e percezione visiva*; Feltrineli, 1994
- Ferid HUDHRI; *Albania through art*; Donika Bardha Albanian Arts Foundation, Tirana, 2007
- Edward Lucie-Smith; *ARTI VISIVE del XX SECOLO*; Konemann, 2000
- Alan Pipes; *Foundation of Art and Design*; Laurence King Publishing, 2013
- Muzafer Korkuti; *Arti shkëmbor në Shqipëri*; Instituti i Arkeologjisë, TIRANË 2008

Burimet e fotografive/ilustrimeve:

<https://www.dreamstime.com/>

<http://www.lascaux.culture.fr/?lng=en#/fr/00.xml>

http://en.museodealtamira.mcu.es/Prehistoria_y_Arte/la_cueva.html

<http://www.virtual-egyptian-museum.org/Collection/FullVisit/Collection.FullVisit-FR.html>

<http://www.egyptianmuseum.org/virtualgallery>

<http://www.louvre.fr/en/departments/egyptian-antiquities>

<http://ancient-greece.org/archaeology/knossos.html>

http://www.metmuseum.org/toah/hd/ecyc/hd_ecyc.htm

<http://archeoroma.beniculturali.it/en/museums/national-roman-museum-palazzo-massimo-alle-terme>

<http://archeoroma.beniculturali.it/siti-archeologici/colosseo>

http://www.qsa.edu.al/index.php?option=com_content&view=article&id=71&Itemid=174&lang=sq

<http://www.mhk.gov.al/?portfolio=pavijoni-i-lashtesise>

<https://www.facebook.com/muzeuarkeologjikdurrres/>

<http://www.expoaus.org/al/parku-kombetar-i-butrintit-uso12>

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016:741(075.2)

Nini, Silvana

Art figurativ 6 : për klasën e 6-të të arsimit 9-vjeçar / Silvana Nini,
Zeni Ballazhi, Hazir Haziri. - Prishtinë : Pegi, 2024. - 102 f. : ilustr. ;
20.7x28 cm

1. Ballazhi, Zeni 2. Haziri, Hazir

ISBN 978-9951-843-30-0